



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 655/20 Prot.

Tiranë, më 15.09/2023

Lënda: Dërgohet Projekt Raporti i auditimit mbi zbatimin e rekomandimeve

Drejtuar: Z. Roland ZISI

REKTOR I UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI"

VLORE

Në zbatim të Programit të Auditimit, nr.655 prot., datë 17/07/2023, mbi "Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduara gjatë vitit 2022", grupi i auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, më datë 11/09/2023, ka përfunduar punën audituese në subjektet në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Universitetin Politeknik Tiranë, Universitetin "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër dhe Universitetin "Fan S. Noli" Korçë, me objekt "Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduara gjatë vitit 2022", për auditimin me temë: "Performanca e Universiteteve Publike gjatë periudhës së pandemisë" të kryer në vitin 2022.

Në përfundim, rezultatet e punës janë pasqyruar në Projekt Raportin e Auditimit, ku përfshihen gjetjet dhe konkluzionet përkatëse, 1 (një) kopje e të cilit i bashkëlidhet kësaj shkrese.

Në mbështetje të neneve 26 dhe 29 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", brenda 1 (një) muaji nga dita e marrjes së Projekt Raportit të Auditimit, të përcillen në KLSH deklarata e nënshkruar nga Titullari ose personi i autorizuar prej tij, që konfirmon njohjen me Projekt Raportin, si dhe komentet e shpjegimet (në formë shkresore dhe në formë elektronike, në CD) nga personat përgjegjës lidhur me gjetjet e auditimit. Në rast mos përgjigjeje në afatet e caktuara, Projekt Raporti konsiderohet i mirëqenë dhe do të vijohet me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.


Në dakortësi të palëve, brenda një afati prej 5 (pesë) deri në 7 (shtatë) ditë nga mbërritja e përgjigjes Tuaj në Kontrollin e Lartë të Shtetit, organizohet Takimi Përmblyës për diskutimin mbi rezultatet e auditimit dhe komenteve nga subjekti i audituar.

Ju falënderojmë për mirëkuptimin.

KRYETAR

Arben SHEHU





PROJEKTRAPORT AUDITIMI

PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LENA NË VITIT 2022

Tiranë, 2023



**PROJEKT RAPORT I AUDITIMIT TEMATIK “PËR VERIFIKIMIN E
ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E
MËPARSHME TË EVADUARA**

**PROJEKT RAPORT I AUDITIMIT TEMATIK
“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË
AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA”**

PËR PERIUDHËN 01.01.2022 DERI 31.12.2022

**MBI AUDITIMIN ME TEMË: “Performanca e Universiteteve Publike gjatë periudhës së
pandemisë” për periudhën Mars 2019 – Dhjetor 2021.”**

NË SUBJEKTET:

- ✓ **MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTEVE**
- ✓ **UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**
- ✓ **UNIVERSITETI “ALEKSANDËR XHUVANI” ELBASAN**
- ✓ **UNIVERSITETI “FAN S.NOLI” KORÇË**
- ✓ **UNIVERSITETI “EQREM ÇABEJ” GJIROKASTËR**
- ✓ **UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE**

SHTATOR 2023

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
1. Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh	3
3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh	4
4. Statusi i pranimet të rekomandimeve	4
II. HYRJA	5
II.1. Objekti auditimit:	5
II.2. Qëllimi auditimit:	5
II.3. Metodologjia e auditimit:	5
II.4. Konkluzioni:.....	6
II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna	7
III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:	7
IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:.....	35
ANEKSE	39

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit

Nga verifikimi rezultoi që:

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), në zbatim të programit të auditimit nr. 655 prot, datë 17.07.2023 mbi "Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet në auditimet e performancës të evaduar gjatë vitit 2022", ushtroi auditim në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Universitetin Politeknik Tiranë, Universitetin "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër dhe Unëversitetin "Fan S. Noli" Korçë si subjekte pjesë e Auditimit të Përformancës me temë: *"Performanca e Universiteteve Publike gjatë periudhës së pandemisë"*.

Auditimi i kryer në vitin 2022, kishte si periudhë auditimi Mars 2019 – Dhjetor 2021 dhe konkluzionet e tij janë miratuar me Vendimin nr. 193 datë 07.10.2022 të Kryetarit të KLSH-së si dhe u janë përcjellë subjekteve të audituara me shkresën nr. 400/14 prot, datë 07.10.2022. Auditimi u krye nga data 25.07.2023, deri më datë 10.09.2023, duke i kushtuar vëmendje të posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2022, hartimin e programeve (plan veprimeve) nga subjektet e audituara, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- b. Nxjerrjen nga Titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si vendime, urdhëra për zbatimin e masave organizative;
- c. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjektet objekt auditimi u mbajtën Akt-Verifikimet përkatëse të cilat janë regjistruar përkatësisht në:

- Ministria e Arsimit dhe Sporteve me nr. 5386/1 prot, datë 31.08.2023;
- Në Universiteti Politeknik Tiranë me nr. 1138/2 prot, datë 04.09.2023
- Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan me nr. 166/14 prot, datë 04.09.2023
- Universiteti "Fan S. Noli" Korçë nr. 1176/2 prot, datë 06.09.2023
- Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër me nr. 1093 prot, datë 04.09.2023
- Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë me nr. 1382/1 prot, datë 06.09.2023

Lidhur me Akt-Verifikimet e lëna nga ana e subjekteve të mësipërme nuk ka patur observacione duke vlerësuar me objektivitet rekomandimet dhe konstatimet e grupit të auditimit mbi zbatimin e rekomandimeve, si dhe vënja e theksit tek rekomandimet që janë në proces zbatimi për të vazhduar zbatimin e tyre në vijimësi.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezultoi:

Ministria e Arsimit dhe Sporteve:

Nga auditimi u konstatua se, ka kthyer përgjigje me shkresë nr. 1003/1 prot., datë 16.02.2023 mbi pranimin e rekomandimeve dhe Planin e masave për zbatimin e tyre në mënyrë të detajuar.

Në Universiteti Politeknik Tiranë :

Nga auditimi u konstatua se, ka kthyer përgjigje me shkresë nr. 2490/1 prot., datë 24.11.2022 mbi pranimin e rekomandimeve dhe Planin e masave për zbatimin e tyre në mënyrë të detajuar.

Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan:

Nga auditimi u konstatua se, ka kthyer përgjigje me shkresë nr. 166/11 prot., datë 19.11.2022 mbi pranimin e rekomandimeve dhe Planin e masave për zbatimin e tyre në mënyrë të detajuar.

Universiteti "Fan S. Noli" Korçë:

Nga auditimi u konstatua se, ka kthyer përgjigje me shkresë nr. 1017 prot., datë 24.11.2022 mbi pranimin e rekomandimeve dhe Planin e masave për zbatimin e tyre në mënyrë të detajuar.

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë :

Nga auditimi u konstatua se, ka kthyer përgjigje me shkresë nr. 1468 prot., datë 15.11.2022 mbi pranimin e rekomandimeve dhe Planin e masave për zbatimin e tyre në mënyrë të detajuar.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë:

Nga auditimi u konstatua se, ka kthyer përgjigje me shkresë nr. 1282/1 prot., datë 24.11.2022 mbi pranimin e rekomandimeve dhe Planin e masave për zbatimin e tyre në mënyrë të detajuar.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna".

Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e këtij afati rezultoi se:

Ministria e Arsimit dhe Sporteve:

Nga auditimi u konstatua se, ka kthyer përgjigje me shkresë nr. 5386/1 prot., datë 29.08.2023 mbi zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të detajuar të cilat do trajtohen në këtë Projektraport auditimi.

Në Universiteti Politeknik Tiranë :

Nga auditimi u konstatua se, ka kthyer përgjigje me shkresë nr. 1738/1 prot., datë 29.08.2023 mbi zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të detajuar të cilat do trajtohen në këtë Projektraport auditimi.

Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan:

Nga auditimi u konstatua se, ka kthyer përgjigje me shkresë nr. 166/13 prot., datë 28.07.2022 mbi zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të detajuar të cilat do trajtohen në këtë Projektraport auditimi.

Universiteti "Fan S. Noli" Korçë:

Nga auditimi u konstatua se, ka kthyer përgjigje me shkresë nr. 1176/1 prot., datë 31.08.2023 mbi zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të detajuar të cilat do trajtohen në këtë Projektraport auditimi.

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë :

Nga auditimi u konstatua se, ka kthyer përgjigje me shkresë nr. 1093/1 prot., datë 04.09.2023 mbi zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të detajuar të cilat do trajtohen në këtë Projektraport auditimi.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë:

Nga auditimi u konstatua se, ka kthyer përgjigje me shkresë nr. 1382/1 prot., datë 04.09.2023 mbi zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të detajuar të cilat do trajtohen në këtë Projektraport auditimi.

4. Statusi i pranimit të rekomandimeve:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr.103/22, 23, 24, 25, 26, 27prot, datë 01.11.2022, janë rekomanduar gjithsej:

✓ Masa organizative 19 rekomandime

Sipas masave të marra nga institucionet respektive, shkresave të cituara më sipër tek respektimi i afatit 20 ditor të përcjellë nga MAS dhe 5 universitetet “Mbi planin e masave”, lidhur me rekomandimet e lëna rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	19	19	-

II. HYRJA

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në vitin 2022, është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve” miratuar me shkresën nr. 341/17 prot., datë 13.06.2021.

Auditimi u krye në bazë të Programit të Auditimit nr. 655 prot, datë 17.07.2023 “Njoftim për fillim projekt auditimi tematik për zbatimin e rekomandimeve”. Rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit të mëparshëm me temë “Performanca e Universiteteve Publike gjatë periudhës së pandemisë” me konkluzionet përkatëse janë miratuar me Vendimin nr.193 datë 07.10.2022 të Kryetarit të KLSH-së dhe janë përcjellë në subjektet e audituara me shkresat nr. nr.103/22,23,24,25,26,27prot, datë 01.11.2022

Auditimi u krye nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë:

1. Bajram Lamaj, *përgjegjës grupi*
2. Aleksandra Trebicka, *anëtar*
3. Ardian Simoni, *anëtar*

Auditimi ka filluar më, 25.07.2023
Auditimi përfundon më, 15.09.2023

II.1. Objekti i auditimit

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Universitetin Politeknik Tiranë, Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë dhe Universitetin “Fan S. Noli” Korçë, me shkresat nr.103/22, 23, 24, 25, 26, 27prot, datë 01.11.2022, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit.

II.2. Qëllimi i auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II.3. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektit në të ardhmen.

II.4. Konkluzioni:

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe Universiteti Politeknik Tiranë, Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër dhe Universiteti “Fan S. Noli” Korçë , në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresat nr.103/22, 23, 24, 25, 26, 27 prot, datë 01.11.2022, rezulton se nga **22 (njëzet e dy) masa të rekomanduara** gjithsej, të cilat janë pranuar nga subjektet e audituara.

Nga këto masa:

- ✓ janë zbatuar **17 rekomandime** ose 77 % e tyre,
- ✓ gjenden në proces zbatimi **5 rekomandime** ose 23% e tyre,

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Ndryshime apo përmirësime ligjore	3	2	-	1	-
2	Masa organizative	19	15	-	4	-
	Gjithsej	22	17	-	5	-

Në numër dhe në % statusi i masave paraqitet si më poshtë:

Nr.	Statusi i masave për ndryshim apo përmirësim ligjor	Në numër	Në %
1	Totali	3	100
2	Pa pranuar	-	-
3	Pranuar	3	100
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	Zbatuar Plotësisht	2	67
2	Zbatuar pjesërisht	-	-
3	Në proces zbatimi	1	33
4	Pa zbatuar	-	-

Nr.	Statusi i masave organizative	Në numër	Në %
1	Totali	19	100
2	Pa pranuar	0	-
3	Pranuar	19	100
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	Zbatuar Plotësisht	15	79
2	Zbatuar pjesërisht	0	-
3	Në proces zbatimi	4	21

4	Pa zbatuar	-	-
---	------------	---	---

II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Puna e bërë nga subjektet e auditimit, MAS dhe Universiteti Politeknik Tiranë, Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë dhe Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, si institucione përgjegjëse për menaxhimin e mesimdhënies në universitete, ku MAS ka për detyrë hartimin dhe zbatimin e politikave të Arsimit të Lartë, si organi epror i 5 IAL-eve, reflektohet me një nivel zbatimi të rekomandimeve rreth 77%, i cili është tregues pozitiv i vlerësimit dhe pranimit të rekomandimeve në funksion të ndryshimit dhe përmirësimit të menaxhimit në të aktivitetit të IAL-eve në kushte situatash të jashtëzakonshme si pandemi, fatkeqësi natyrore, etj. Rezulton se vetëm 1 rekomandim për përmirësim ligjor nuk është zbatuar plotësisht, por gjithësesi është në proces zbatimi, kjo dhe për arsye të shtrirjes mbi afatin e vendosur të zbatimit të tyre, pra zbatimi i tyre kërkon më shumë kohë dhe nga masat organizative të lëna nuk janë realizuar 4 rekomandime, të cilat janë në proces zbatimi, kjo për arsye se fuzha e zbatimit të tyre në shtrirje kohore i përket një periudhe kohe më të gjatë se afati (vijimësi). Rëndësia dhe ndjeshmëria e temës objekt auditimi kërkon më tepër impenjim nga subjektet e audituara për përmbushjen plotësisht të rekomandimeve të lëna dhe garantimin e një menaxhimi më të mirë në situata emergjence dhe fatkeqësie natyrore me qëllimin e vetëm, mosçënimin e procesit mësimor në IAL-et.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

Më konkretisht, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1.1. Për pyetjen audituese: *A janë zbatuar politikat, aktet ligjore dhe nënligjore të dala, si dhe udhëzimet e Komitetit të ekspertëve?*

Gjetje nga auditimi: 1. Nga verifikimi i dokumentave dhe akteve, lidhur me politikat në fushën e mbrojtjes civile dhe zbatimin e tyre, u konstatua se *nuk është miratuar një Strategji Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, në shkellje të nenit 10, pika 1, i cili përcakton se:* “Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë është dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë që përcakton politikat e aktivitetet e institucioneve dhe të strukturave qendrore e vendore, si dhe të gjitha subjekteve të tjera në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit” edhe pse është në zbatim Ligji Nr. 45/2019.

Mungesa e strategjisë është në kundërshtim me objektivin e pestë të kuadrit SENDAI¹ të reduktimit të riskut të fatkeqësive: “Rritja në mënyrë thelbësore e numrit të vendeve me strategji të reduktimit të riskut kombëtar dhe lokal të fatkeqësive deri në vitin 2020”.

Mungesa e strategjisë evidentohet si një mangësi në gjetjet e njëpasnjëshme të raporteve të progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, përfshirë edhe raportin e progresit të fundit për vitin 2018². Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion prej MAS, rezulton se në PPAP (planifikimi i proceseve të aktivitetit të programuar) 2022 të Ministrisë së Mbrojtjes, është

¹ Sendai është një qytet prej një million banorësh në Japoni, ku me 15 mars 2015, shtetet anëtare të OKB - së u mbledhën në Konferencën Botërore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, ku u miratua dokumenti I njohur si Kuadri i Sendait, më pas I aprovuar nga Asamblea e Kombeve të Bashkuara në qershor 2015

² <https://parlament.al/Files/ProjektLigje/20190610101549RELACION%20%20MBROJTA%20CIVILE.pdf>

parashikuar miratimi i Strategjisë, në katërmujorin III të vitit 2022. Bazuar në Urdhrin të Kryeministrit nr. 57, datë 29.06.2021 (nr. prot. 3664, datë 29.06.2021, protokoll të Ministrisë) “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës për përgatitjen e projektit të Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë”, ka filluar puna për hartimin e saj dhe referuar pikës 2, germa dh, të njëjtit urdhër, anëtar i Grupit Ndërinstitucional të punës, në përfaqësim të MASR, është Zëvendësministri i këtij dikasteri.

1.2. Po ashtu, u konstatua se edhe pse është në zbatim Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, datë 18.07.2019, nuk është miratuar ende një Plan Kombëtar për Emergjencat Civile. Duke qenë se Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 14, pika 4, parashikon se: “Plani Kombëtar për Emergjencat Civile miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit”³, atëherë shtrohet nevoja përgatitjes dhe miratimit të tij, sapo të jetë miratuar Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.

1.3. Konstatohet se MAS, në zbatim të Ligjit Nr. 8756, datë 26.03.2001, ka miratuar më datë 08.08.2019, me nr. 7856 prot., “Rregulloren për parandalimin e gjendjes së fatkeqësive natyrore, ose të fatkeqësive të tjera dhe masat e jashtëzakonshme”⁴. Kjo ministri, ka detyrim, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, datë 18.07.2019, neni 22, pika 2, germa a, të hartojë, miratojë dhe përditësojë planin për emergjencat civile, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore dhe ta dërgojë atë në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllime analize dhe planifikimi, ndërkohë që akoma nuk e ka miratuara një dokument të tillë, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, datë 18.07.2019

Rekomandimi 1. Ministria e Arsimit dhe Sportit nëpërmjet përfaqësuesit të saj, të kontribuojë pranë Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës për përgatitjen e projektit të Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga fatkeqësitë, duke pasuruar me përvojat dhe nevojat e shfaqura edhe gjatë periudhës së pandemisë nga Covid-19 në IAL – e publike shqiptare në përmbajtjen e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Të sensibilizojë të gjithë mekanizmat politikëbërës dhe vendimmarrës, për miratimin sa më të shpejtë të saj. Ministria e Arsimit dhe Sporteve pas miratimit të strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga fatkeqësitë, të përgatisë dhe ndjekë miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile.

Rekomandimi 1.2. Ministria e Arsimit dhe Sporteve të miratojë dhe përditësojë planin për emergjencat civile, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore të ngarkuar, sapo të jetë miratuar Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Planit Kombëtar për Emergjencat Civile.

MAS

Konstatohet se: MAS ka respektuar afatet e përcaktuara në përcjelljen e informacionit të kërkuar prej saj, në mënyrë që procesi i hartimit deri tek miratimi i strategjisë të ishte sa më i shpejtë dhe në respektim të plotë të afateve kohore. Aktualisht, “Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë” është miratuar me vendimin nr. 94, datë 22.2.2023 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023 - 2030 dhe Planit të Veprimit”.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 58, datë 29.06.2021, “Për Ngritjen e Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës për Përgatitjen e Projektit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile”, grupi i punës filloi punën për hartimin e këtij plani dhe aktualisht është hartuar draft plani i veprimit, si dhe ka përfunduar edhe faza e konsultimit publik. Bashkëlidhur linku ku mund të gjendet draft Planit Kombëtar për Emergjencat Civile:

³ Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 14, pika 4.

⁴ Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 22, paragrafi 1 dhe 2, germa a. dhe b.

chrome-

extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJ_K_630_PKEC.pdf

Hartimi i planit kombëtar për rimëkëmbjen dhe qëndrueshmërinë e sistemit arsimor ndaj emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore është në proces konsultimi publik.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar dhe verifikimit elektronik konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin, është punuar për hartimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile dhe aktualisht është hartuar draft plani i veprimit, si dhe është në fazën e konsultimit publik.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe është në proces zbatimi për efekt shtrirje kohore .

Gjetja nga auditimi: 2. Përfshirja e formës së studimeve në distancë, në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” u ka pamundësuar IAL–ve, duke filluar nga viti 2015, përdorimin e platformave elektronike dhe familjarizimin e thelluar me TIK, në funksion të shfrytëzimit të tyre, për realizimin me sukses dhe pa pengesa të proceseve mësimore online, në kushte normale, sikurse dhe në kushtet e jashtëzakonshme, si ato gjatë periudhës së pandemisë. Kjo e vendos arsimin e lartë jashtë standarteve mësimore ndërkombëtare të përparuara të e – learning.

Rekomandimi 2. Ministria e Arsimit dhe Sporteve si institucioni përgjegjës për arsimin, të formulojë dhe propozojë një amendim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, duke parashikuar dhe përfshirë mundësisë e zhvillimit të proceseve mësimore online, nëpërmjet rikthimit të formës së studimeve në distancë, ose duke ua atribuar haptazi IAL–ve, në lirinë e tyre akademike dhe organizative, zgjedhjen dhe vlerësimin që t’a aktivizojnë, sipas nevojave dhe specifikave përkatëse.

MAS

Konstatohet se: Në kushtet e situatës së krijuar nga pandemia e shkaktuar nga virusi Covid-19, procesi mësimdhënës *online* u pa nga IAL–të, si e vetmja mënyrë për vijimin e ofrimit të shërbimit arsimor. Metoda *online* apo e kombinuar, është një nga metodologjitë e realizimit të procesit mësimor, por nuk mund të cilësohet si një nga format e studimit që janë të sanksionuara në nenin 69 të ligjit nr. 80/2015. Ky ligj nuk ndalon zhvillimin e procesit mësimor online si metodë mësimdhënie që aplikohet në raste të veçanta si efekte të fatkeqësive natyrore, pandemie, konflikteve të armatosura etj. Mënyra/metodologjia e zhvillimit të veprimtarive mësimore është element i cili mund të parashikohet për secilën nga format e studimit të parashikuara në ligjin nr.80/2015, në funksion të zhvillimit të procesit sipas kushtëzimeve që lindin për efekte të fatkeqësive natyrore, pandemie, konflikteve të armatosura etj.

Për sa më lart, nga ana e MAS nuk vlerësohet se jemi në kushtet e ndryshimit të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar sqarimeve të MAS, konstatohet se është pranuar si rekomandim, por për arsye të mosndalimit të mësimin online nga ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e Lartë”, është vlerësuar se IAL–et kanë të drejtë në periudha të fatkeqësive natyrore, pandemie, konflikteve të armatosura, etj., të gjejnë mënyra alternative në metodologjinë e realizimit të procesit mësimor, por jo trajtimin si një nga format e studimit të parashikuara në ligjin 80/2015. Pra, megjithëse e pranojnë si rekomandim dhe nuk kontestohet fenomeni, sqarojnë se nuk mund t’a ligjërojnë si formë studimi mësimin online, pasi ka risk të lartë. Në këto kushte për mungesë të fushës së zbatimit nga grupi i auditimit meret në konsideratë sqarimi dhe rekomandimi quhet i realizuar, pasi është njohur nga struktura metodologjia e mësimin online.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe i zbatuar (sqaruar se nuk ka fushë zbatimi si formë studimi).

Gjetje nga auditimi: 3. Mësimi online, si formë mësimi që zëvendëson dhe kompensonte mësimin në auditor, nuk u parashikua nëpërmjet një përcaktimi të qartë ligjor, sikurse parashikohet në Kushtetutën e RSH-së, neni 170, paragrafi 3, ku nënvizohet se: “Ligji duhet të përcaktojë parimet, fushat dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve që vijnë si rezultat i kufizimit të të drejtave dhe lirive gjatë marrjes së masave të jashtëzakonshme”⁵, por MASR është mjaftuar me dërgimin e një e-maili, ku u kërkohej IAL-ve që: “Çdo universitet dhe çdo fakultet duhet të gjejë zgjidhje sa më të shpejta për të siguruar alternativën e mësimi online.....”⁶

Rekomandimi 3. Ministria e Arsimit dhe Sporteve të hartojë dhe dërgojë për miratim rishikimet ligjore, duke përcaktuar dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve apo kufizimit të drejtave për arsimin në situata të jashtëzakonshme, përfshirë edhe format e studimit dhe praktika e ndjekur për zhvillimin e mësimi online dhe jo në auditor.

MAS

Konstatohet se: MAS, përveç sa ka sqaruar më lart mbi metodologjinë e mësimdhënies online, bën me dije se, pavarësisht situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, e drejta për arsim dhe studim nuk është cënuar, duke qenë se kjo metodologji arriti t’iu sigurojë mundësi pjesëmarrjeje të gjithë studentëve.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar sqarimeve të MAS, konstatohet se është pranuar si rekomandim, por për arsye të zbatimit të mënyrave alternative në metodologjinë e realizimit të procesit mësimor në situata të vecanta siç ishte pandemia, me gjithë vështirësitë ka arritur të mos cënojë mësimin sipas vlerësimit tyre institucional, por duhet që të kihet parasysh përparitja e planeve të vecanta mesimore për situata emergjencee fatkeqësi, duke patur parasysh të drejtën për arsimim të plotë nga institucionet arsimore.

Në këto kushte për mungesë të fushës së zbatimit dhe mungesë të situatave që kërkojnë impenjime të këtij lloji, nga grupi i auditimit merret në konsideratë sqarimi dhe rekomandimi quhet i realizuar, pasi është vlerësuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe i zbatuar (nuk ka fushë zbatimi dhe situatë ekzistente).

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1.1 A janë zbatuar politikat, aktet ligjore dhe nënligjore të dala, si dhe udhëzimet e Komitetit të ekspertëve?

Gjetja nga auditimi: 4. IAL-et duke mos njohur Rezolutën 2001/C 204/02, e njohur si Rezoluta mbi e-learning, e miratuar nga Këshilli i Ministrave të Arsimit të vendeve anëtare të BE më 13 Korrik 2001 mbi e-learning, dëshmojnë se kanë mangësi lidhur me informacionin që lidhet me praktikën e e-learning, të rekomanduar që para disa dekadave në vendet e BE - së.

Rekomandimi 4 “IAL-të të thellojnë njohuritë e veta mbi dokumentet dhe praktikën e mira të e-learning, me qëllim reflektimin e tyre në proceset e tyre mesimore”.

-Universiteti Politeknik Tiranë

Konstatohet se: Lidhur me këtë rekomandim, megjithëse mësimi në distancë nuk parashikohet nga legjislacioni në fuqi si formë e zakonshme studimi, Universiteti Politeknik i Tiranës ka tashmë

⁵ Kushtetuta e RSH në nenin 170, paragrafi 3

⁶ E-mail – i, i datës 16 mars 2020, me objekt: “Në lidhje me opsionin e mësimi në distancë”, dërguar nga zv. Ministri i MASR, z. O. Rr., të gjithë rektorëve dhe dekanëve të IAL – ve.

një platformë të unifikuar elektronike për zhvillimin e procesit mësimor online, e cila aktualisht përdoret gjerësisht nga personeli akademik për t'i ardhur në ndihmë studentëve me informacione dhe materiale didaktike, si dhe për të komunikuar me ta për çështje të ndryshme që lidhen me procesin mësimor.

Njëkohësisht, janë udhëzuar të gjitha strukturat, në nivel institucioni, njësie kryesore apo njësie bazë, për njohjen dhe azhurnimin mbi dokumentat dhe praktikën e *e-learning*.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UPT, vlerësohet se është pranuar si rekomandim dhe zbatuar, si pjesë e edukimit të vazhdueshëm të stafit akademik e mësimdhënës. Në këto kushte nga grupi i auditimit, rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

-Universiteti "Aleksandër Xhuvani"

Konstatohet se: Lidhur me këtë rekomandim, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", pas periudhës së pandemisë 2020-2022 ka zhvilluar veprimtari në kuadër të digjitalizimit, teknologjisë së informacionit në mësimdhënie, metodave bashkëkohore dhe mësimdhënies online. Njëkohësisht janë udhëzuar të gjitha strukturat, në nivel institucioni, njësie kryesore apo njësie bazë, se kanë për detyrë të arzhonohen mbi bashkësinë e dokumentave dhe praktikave të *e-learning*. Njëherazi të gjitha vendimmarrjet dhe aktet rregullatore të UNIEL, po strukturohen mbi këtë bazë. Është një detyrë që do të gjejë zbatim në vijimësi.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UNIEL, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatim, por ky rekomandim është në proces, si pjesë e edukimit të vazhdueshëm të stafit akademik e mësimdhënës. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces zbatimi në vijimësi.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi vijimësi.

-Universiteti "Fan S. Noli" Korçë

Konstatohet se: Universiteti "Fan S. Noli" pas periudhës së pandemisë 2020-2023 zhvilloi veprimtari në kuadër të digjitalizimit, teknologjisë së informacionit në mësimdhënie, metodave bashkëkohore dhe mësimdhënies online. Lidhur me këtë rekomandim, UKorçë, pas periudhës së pandemisë 2020-2022 ka zhvilluar veprimtari në kuadër të digjitalizimit, teknologjisë së informacionit në mësimdhënie, metodave bashkëkohore dhe mësimdhënies online. Njëkohësisht, është ngritur grup pune, i drejtuar nga Zv. Rektori Akademik për të thelluar njohuritë mbi praktikën e-learning dhe janë udhëzuar të gjitha strukturat, në nivel institucioni, njësie kryesore apo njësie bazë, se kanë për detyrë të arzhonohen mbi bashkësinë e dokumentave dhe praktikave të *e-learning*. Është një detyrë që do të gjejë zbatim në vijimësi.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UKorçë, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatim, por ky rekomandim është në proces, si pjesë e edukimit të vazhdueshëm të stafit akademik e mësimdhënës. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces zbatimi në vijimësi.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi vijimësi.

-Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë

Konstatohet se: Lidhur me këtë rekomandim, të gjitha strukturat, në nivel institucioni, njësie kryesore apo njësie bazë, kanë për detyrë të arzhonohen mbi bashkësinë e dokumentave dhe praktikave të *e-learning*. Njëherazi të gjitha vendimmarrjet dhe aktet rregullatore të UGJ-së, të strukturohen mbi këtë bazë. Është një detyrë që do të gjejë zbatim në vijimësi.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UGJ, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar

zbatimi, por ky rekomandim është në proces, pasi duhet të vazhdojë zbatimi dhe rishikimin e Rregullores së UGJ. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces zbatimi në vijimësi.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi vijimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin, është hartuar dhe miratuar strategjia e KSHP për periudhën 2020-2025.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar pjesërisht.

-Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë

Konstatohet se: Lidhur me këtë rekomandim, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë”, pas periudhës së pandemisë 2020-2022 ka zhvilluar veprimtari në kuadër të digjitalizimit, teknologjisë së informacionit në mësimdhënie, metodave bashkëkohore dhe mësimdhënies online. Njëkohësisht, është ngritur grup pune, i drejtuar nga Zv. Rektori Akademik për të thelluar njohuritë mbi praktikën e-learning dhe janë udhëzuar të gjitha strukturat, në nivel institucioni, njësie kryesore apo njësie bazë, se kanë për detyrë të arzhonohen mbi bashkësinë e dokumentave dhe praktikave të e-learning. Njëherazi të gjitha vendimmarrjet dhe aktet rregullatore të UV, do të strukturohen mbi këtë bazë. Është një detyrë që do të gjejë zbatim në vijimësi.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UVlorë, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimi, por ky rekomandim është në proces, si pjesë e edukimit të vazhdueshëm të stafit akademik e mësimdhënës. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces zbatimi në vijimësi.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi vijimësi.

Për pyetjen audituese: 1.1.2. A i ka shërbyer ky kuadër arritjes së objektivave të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe mbrojtjes së shëndetit të studentëve dhe stafit akademik?

Gjetja nga auditimi: 5. Këshillat studentorë, ndryshe nga sa parashikohet në Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 99, sikurse konstatohet nga përgjigjet e dhëna nga IAL-et, ose nuk janë ngritur dhe funksionuar, ose nuk kanë qenë aktiv, gjatë periudhës pandemisë. Ndaj, studentëve u kanë munguar zëdhënësit e drejtpërdrejtë të tyre dhe problemeve të cilat i kanë shqetësuar gjatë kohës së pademisë shkaktuar nga Covid 19.

Rekomandimi 5. Institucionet e Arsimit të Lartë pa cënuar lirinë e organizimit të studentëve në këshilla studentorë, të nxisin, inkurajojnë dhe mbështesin, ngritjen dhe funksionimin e këshillave studentorë, me synim diskutimin, trajtimin dhe zgjidhjen e problematikave me të cilat ndeshen studentët.

-Universiteti Politeknik Tiranë

Konstatohet se: Lidhur me këtë rekomandim, Sektori Juridik ka vënë në dispozicion të grupeve studentore të interesuara dhe përfaqësuesve të tyre në Senat, një model të draft statutit dhe draft rregulloreve për funksionimin e Këshillave Studentorë, me qëllim hartimin dhe miratimin e tyre nga organet drejtuese të UPT, por përsëri mbetet i kufizuar për të ndërmarrë rol aktiv në këtë proces për shkak të kufizimeve ligjore.

Me fillimin e vitit akademik 2023–2024, institucioni do të ofrojë përsëri ndihmën për bashkëpunimin me grupet studentore, me qëllim realizimin e këtij rekomandimi dhe miratimin akteve përkatëse që do ti hapin rrugë ngritjes së këshillave studentore.

Gjithashtu, janë programuar takime me grupe studentore të organizuara, të cilat do të shërbejnë si ura lidhëse për trajtimin e problematikave të studentëve në përditshmërinë e tyre për vitin akademik 2023-2024. Për sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet i pranuar e në proces zbatimi.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UPT, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, dhe është në proces zbatimi. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe proces zbatimi.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe proces zbatimi.

-Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan

Konstatohet se Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” i ka të ngritura strukturat e Këshillave studentore në shkallë njësie kryesore dhe në shkallë IAL-je. Me këto struktura janë kryer takime në datat: FE - datë 02.03.2023, datë 06.03.2023; FSHMT - datë 06.03.2023, datë 13.03.2023, datë 16.03.2023; FSHE - datë 02.03., datë 09.03.2023, datë 13.03.2023; FSHH - datë 02.03.2023, datë 09.03.2023, datë 16.03.2023; FSHN - datë 06.03.2023, datë 09.03.2023, datë 16.03.2023. Këto takime vijnë të shërbejnë si ura lidhëse për trajtimin dhe lidhjen e problemeve të studentëve në përditshmërinë e tyre për vitin akademik 2023-2024. Gjithashtu janë përcjellë në vijimësi problematikat e tyre në Senatin Akademik, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në këtë senat.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UNIEL, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, dhe është zbatuar. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

-Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë

Konstatohet se: Senati Akademik, pasi diskutoi lidhur me këtë rekomandim, la për detyrë si vijon: struktura që do të inkurajojë dhe mbështesë ngritjen dhe funksionimin e Këshillave studentore, do të jetë Sektori i Shërbimeve Bibliotekare-Arkivore dhe Studentore. Është një strukturë në nivel institucioni, e ngritur me vendime të Senatit Akademik dhe funksionin sipas përcaktimeve në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndihmës Akademike-Administrative”. Me vendim të Senatit Akademik do të miratohen detyrat shtesë të kësaj strukture për ndërtimin e marrëdhënjëve me këshillin studentor të UGJ-së. Këto detyra do të përfshihen në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndihmës Akademike-Administrative”, në rastin e rishikimit të saj.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UGJ, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimi i cili është në proces. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi.

-Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë

Konstatohet se: Është punuar për organizimin e këshillave studentorë nga Universitet “Ismail Qemali” Vlorë” i cili ka të ngritura strukturat e këshillave studentore në shkallë njësie kryesore dhe në shkallë IAL. Vazhdohet puna për rifreskimin e tyre dhe vendosja e një marrëdhënie me hyrjet e reja studentore përvitin 2023-2024. Janë programuar takime me grupe studentore të organizuar të cilat do të shërbejnë si ura lidhëse për trajtimin dhe lidhjen e problemeve të studentëve në përditshmërinë e tyre për vitin akademik 2023-2024. Gjithashtu janë përcjellë në vijimësi problematikat e tyre në Senatin Akademik, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në këtë senat.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UVlora, vlerësohet se është pranuar si rekomandim dhe është zbatuar. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

Gjetja nga auditimi: 6. Procesi auditues evidentoi se: IAL-et ose nuk kanë informacion mbi ecurinë e procesit të pajisjes me kartë studenti, ose në marrëveshjet që kanë nënshkruar me njësitë e vetëqeverisjes vendore, nuk kanë të përfshira shërbime me çmime të reduktuara për nevojat e lindura në periudhën e pandemisë. Po ashtu, IAL-et, nuk kanë nënshkruar “...marrëveshje me subjekte ...private, për ofrimin e shërbimeve të ndryshme,me çmime të reduktuara për përfituesit e kartës së studentit.”⁷, në mungesë të zbatimit të VKM - së Nr. 226, e datës 17.04.2019 “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, pika 6.

Ministria e Arsimit dhe Sporteve të gjitha marrëveshjet i ka lidhur deri në vitin 2019 dhe asnjë në vitet 2020 dhe 2021, duke mos përfshirë në gamën e shërbimeve të ofruara me çmime të reduktuara, objekt marrëveshjes, asnjë shërbim të lidhur me nevojat e krijuara nga situata e pandemisë.

Ministria e Arsimit dhe Sporteve ka nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me Ministrinë e Kulturës dhe Ministrinë e Brendshme, por nuk ka nënshkruar marrëveshje për shërbimet që: “..ofrohen nga entet shtetërore në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, arsimit, sportit dhe rinisë, transportit,..., ekonomisë, financave, punësimit dhe trajnimit... “që përfitohen nga studentët me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit...”⁸, në kundërshtim me VKM-në Nr. 226, datë 17.04.2019, në pikën 1.

IAL-et objekt auditimi dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve nuk kanë bërë inventarizim nevojash të studentëve gjatë periudhës së pandemisë, mbi bazën e të cilave të orientonin veprimtarinë e tyre në mbështetje me promovimin e përfitimin e shërbimeve me çmime të reduktuara nëpërmjet kartës së studentit.

Rekomandimi 6: “IAL –të, në bashkëpunim me entet shtetërore të fushave të ndryshme, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe operatorët e sektorit privat, të përditësojnë dhe pasurojnë spektrin e marrëveshjeve për shërbimet që përfitojnë studentët me çmim të reduktuar, në përputhje me situatat dhe nevojat e lindura”.

-UPTiranë

Konstatohet se: Megjithëse mbështetur në VKM – në 226, datë 17.04.2019, lista e shërbimeve që ofrohen për studentët me çmime të reduktuara, miratohen nga ministrinë përgjegjëse dhe nuk është drejtpërdrejtë atribut i IAL-ve, Universiteti Politeknik i Tiranës ka ndërmarrë veprime për evidentimin e subjekteve private, të cilat mund të ofrojnë shërbime me çmime të reduktuara, për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit.

Konkretisht, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit që Universiteti Politeknik i Tiranës ka lidhur me kompaninë “ONE”, kjo e fundit ka ofruar për studentët e UPT, paketa shërbimi të telefonisë celulare, si dhe shërbimit të internetit me tarifa të reduktuara. Gjithashtu kompania ONE në kuadër të E-Leraninig, ka ofruar për studentët akses falas në platformat Microsoft Teams, Zoom dhe Google Classroom. Për sa më sipër ky rekomandim nga UPT konsiderohet i realizuar.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UPT, vlerësohet se është pranuar si rekomandim dhe realizuar. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe realizuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

-UNIEL

⁷ VKM Nr. 226, e datës 17.04.2019 “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, pika 6.

⁸ VKM Nr. 226, e datës 17.04.2019 “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, pika 1.

Konstatohet se: Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ka kontakte të vazhdueshme me Prefekturën Elbasan, Bashkinë Elbasan, bashkitë e tjera të këtij Qarku (Peqin, Gramsh, Belsh, Cerrik, Librazhd, Prrrenjas) dhe subjekte të ndryshme për të krijuar lehtësira në shërbimet ndaj studentëve. Ky është një shqetësim që ne e kemi në fokusin e përditshëm dhe po punojmë më NJQV-të e Qarkut Elbasan.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UNIEL, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin dhe ky rekomandim është në proces zbatimi. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi (së bashku me Bashkitë e Qarkut Elbasan).

-UNIKO

Konstatohet se: Universiteti “Fan S Noli” Korçë kanë marrë masa për të rifreskuar marrëveshjen e bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe operatorët e sektorit privat për të mundësuar shërbime me çmim të reduktuar për studentëve.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UK, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin dhe ky rekomandim është në proces zbatimi. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi (së bashku me Bashkitë e Qarkut Korçë).

-UGJ

Konstatohet se: Për këtë rekomandim Senati Akademik u fokusua në dy drejtime kryesore: përcaktimin e spektrit të marrëveshjeve në Rregulloren e UGJ-së për shërbimet që duhet të përfitojnë studentët me çmime të reduktuara; rinovimin apo lidhjen e marrëveshjeve të reja me njësitë e qeverisjes vendore (Bashki, Prefektura, Qarqe, zyra e drejtorit arsimorë, spitale e institucione të kujdesit shëndetësor etj.) si dhe me operatorët privat (dhomat e tregëtisë dhe tërësinë e biznesëve). Marrëveshjet bashkëpunuese do të shprehen edhe për tërësinë e shërbimeve që u ofrohen studentëve me çmime të reduktuara.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UGJ, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin dhe ky rekomandim është në proces zbatimi. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi (së bashku me Bashkitë e Qarkut Gjirokastrë).

UVlorë

Konstatohet se: Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë kanë marrë masa për të rifreskuar marrëveshjen e bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe operatorët e sektorit privat për të mundësuar shërbime me çmim të reduktuar për studentëve. Konkretisht është funksionale një Marrëveshje bashkëpunimi midis Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë dhe Bashkisë Vlorë me nr. 335/2 prot., datë 17.05.2019. Po punohet me subjekte të ndryshme për të krijuar lehtësira në shërbimet ndaj studentëve.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UV, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin dhe ky rekomandim është në proces zbatimi. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi (së bashku me Bashkitë e Qarkut Vlorë).

Gjetje nga auditimi: 7. Procesi i vaksinimit para fillimit të vitit akademik 2021 – 2022, i inicuar në zbatim të Urdhrit të MSHMS – së, Nr. 413, datë 24.09.2021 “Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit covid -19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët” dhe Urdhërit të MSHMS - së, Nr. 413/1, të datës 27.09.2021 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 413, datë 24.09.2021 “Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit covid -19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët”, i cili ishte kusht për praninë e studentëve në auditore, nuk u përvijua nga IAL –et, në respekt të plotë të sa parashikuar në këto dy akte. Detyrimi i parashikuar në pikën 1, të Urdhërit Nr. 413/1, datë, datë 27.09.2021, që “Studentët duhet të paraqesin certifikatën e vaksinimit COVID-19 apo kartën e vaksinimit, për të hyrë në institucionet e arsimit të lartë, duke filluar nga data 11.10.2021”⁹, nuk është respektuar dhe zbatuar nga IAL –et me rigorozitet dhe studentët kanë qenë të pranishëm në auditore pavarësisht mos vaksinimit të tyre, meqë edhe alternativa e mësimit online për të pavaksinuarit, u hoq pas ndryshimit të pikës 4 të Urdhërit nr. 413, me parashimin e pikës 1 të Urdhërit Nr. 413/1.

Rekomandimi 7. “IAL – të, të marrin masa dhe të bashkëpunojnë me institucionet që bëjnë politikat e shëndetit publik dhe sigurojnë zbatimin e tyre për rastet e fatkeqësive natyrore shkaktuar nga pandemitë, si dhe zbatimin e masave të urdhëruara si të detyrueshme, për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive, përfshirë edhe proceset e vaksinimit masiv”.

-UPT

Konstatohet se: Sikurse është evidentuar edhe nga auditimi, Universiteti Politeknik i Tiranës ka kërkuar në formë shkresore mbështetjen nga institucionet shëndetësore për përballimin e situatës gjatë periudhës së pandemisë dhe vijon të mbetet i gatshëm të bashkëpunojë me to me qëllim realizimin e këtij rekomandimi në situata të ngjashme në të ardhmen.

Lidhur me këtë rekomandim, megjithëse Universiteti Politeknik i Tiranës në bashkëpunim me ISHP ka marrë masat e nevojshme dhe ka siguruar kushtet për vaksinimin e studentëve gjatë periudhës së situatës së jashtëzakonshme, mbetet i angazhuar të rrisë nivelin e bashkëpunimit nëpërmjet MAS por edhe drejtëpërdrejtë sikurse evidentohet nga auditimi i kryer, me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, me qëllim realizimin plotësisht të këtij rekomandimi në rastet e fatkeqësive natyrore të shkaktuar nga pandemitë në të ardhmen, për parandalimin e përhapjes së sëmundjes infektive.

Angazhimi i përbashkët dhe përvoja e fituar gjatë asaj periudhe, do të shërbejë si garanci për përballimin e situatave të ngjashme në të ardhmen.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i realizuar pjesërisht.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UPT, vlerësohet se është pranuar si rekomandim dhe zbatuar. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

-UNIEL

Konstatohet se:

Nga ana UNIEL ka patur marrëdhënie të ngushta me institucionet e shëndetit publik të Qarkut Elbasan si në periudhën e pandemisë dhe në vazhdimësi. Gadishmëria e tyre, angazhimi i përbashkët dhe përvoja e fituar gjatë asaj periudhe do të shërbejë si garanci për përballimin e situatave të tilla në të ardhmen. UNIEL do të ndërtojë marrëdhënjet me Drejtorinë Rajonale të Shëndetit Publik, në rastet e fatkeqësive natyrore të shkaktuara nga pandemitë. Modalitetet e nevojshme do të trajtohen në marrëveshjet përkatëse me institucionet e shëndetit publik pasi është diskutuar me këto institucione në Qarkun e Elbasanit.

⁹ Urdhëri i MSHMS - së, Nr. 413/1, të datës 27.09.2021 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 413, datë 24.09.2021 “Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit covid -19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët”, pika 1.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UNIEL, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin dhe ky rekomandim është në proces zbatimi. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi (së bashku me institucionet e Qarkut Elbasan).

-UNIKO

Konstatohet se: Është monitoruar në vazhdimësi zbatimi i masave të rekomanduara për rastet e cituara në rekomandimin e lënë. Nga ana e Stafit akademik ka patur marrëdhënie të ngushta me institucionet e shëndetit publik të rajonit tonë si në periudhën e pandemisë dhe në vazhdimësi. Gadishmeria e tyre, angazhimi i përbashkët dhe përvoja e fituar gjatë asaj periudhe do të shërbejë si garanci për përballimin e situatave të tilla në të ardhmen. Në vijimësi nga Administratori i UKorçë ka filluar përgatitja e akteve rregullatore për zbatimin e masave të urdhëruara nga institucionet që nxjerrin urdhra e udhëzime, ose bëjnë politikat e monitorimit të shëndetit publik, si dhe do sigurohet zbatimi i tyre për cdo rast fatkeqsie natyrore, si dhe zbatimin e masave dhe urdhëruara si të detyrueshme për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive, në situatat që mund të paraqiten.

UKorçë ka patur marrëdhënie të mira me institucionet e shëndetit publik të Qarkut Korçë si në periudhën e pandemisë dhe në vazhdimësi. Gadishmeria e tyre, angazhimi i përbashkët dhe përvoja e fituar gjatë asaj periudhe do të shërbejë si garanci për përballimin e situatave të tilla në të ardhmen UKorçë do të ndërtojë marrëdhëniet me Drejtorinë Rajonale të Shëndetit Publik, në rastet e fatkeqsive natyrore të shkaktuara nga pandemitë. Modalitetet e nevojshme do të trajtohen në marrëveshjet përkatëse me institucionet e shëndetit publik në Qarkun e Korçës.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UKorçë, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin dhe ky rekomandim është në proces zbatimi. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi (së bashku me institucionet e Qarkut Korçë).

-UGJ

Konstatohet se: Senati Akademik konkludojë se Rregullorja e rishikuar e Universitetit (e cila është në proces hartimi) do të shprehet për mënyrën se si UGJ-ja do të ndërtojë marrëdhënjet me Drejtorinë Rajonale të Shëndetit Publik, në rastet e fatkeqsive natyrore të shkaktuara nga pandemitë. Modalitetet e nevojshme do të trajtohen në marrëveshjet përkatëse me institucionet e shëndetit publik.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UGJ, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin, por ky rekomandim është në proces. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi.

UNVlorë

Konstatohet se:

Është monitoruar në vazhdimësi zbatimi i masave të rekomanduara për rastet e cituara në rekomandimin e lënë. Në vijimësi nga Administratori i UV ka filluar përgatitja e akteve rregullatore për zbatimin e masave të urdhëruara nga institucionet që nxjerrin urdhra e udhëzime, ose bëjnë politikat e monitorimit të shëndetit publik, si dhe do sigurohet zbatimi i tyre për cdo rast fatkeqsie natyrore si dhe zbatimi i masave dhe urdhëruara si të detyrueshme për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive, në situatat që mund të paraqiten. UVlorë ka patur marrëdhënie

të ngushta me institucionet e shëndetit publik të Qarkut Vlorë si në periudhën e pandemisë dhe në vazhdimësi. Gadishmëria e tyre, angazhimi i përbashkët dhe përvoja e fituar gjatë asaj periudhe do të shërbeje si garanci për përballimin e situatave të tilla në të ardhmen U.Vlorë do të ndërtojë marrëdhëniet me Drejtorinë Rajonale të Shëndetit Publik, në rastet e fatkeqësive natyrore të shkaktuara nga pandemitë. Modalitetet e nevojshme do të trajtohen në marrëveshjet përkatëse me institucionet e shëndetit publik në Qarkun e Vlorës.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UVlorë, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin dhe ky rekomandim është në proces zbatimi. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi (së bashku me institucionet e Qarkut Vlorë).

Për pyetjen audituese: 2.1 Për pyetjen audituese: A është ngritur infrastruktura e duhur për t'ju përgjigjur në kohë dhe me efektivitet situatës së krijuar prej pandemisë Covid 19

Gjetja nga auditimi: 8. Gjatë periudhës së pandemisë të gjithë studentët që zotëronin Kartën e studentit, nga përdorimi i saj ata duhet të kishin përfitime, të tilla si: lehtësirat në shërbimet që u nevojiten për kryerjen e studimeve, (veçanërisht në periudhën e pandemisë), përfitimi i internetit falas, lehtësi lëvizje nga rrethet, ndihmë financiare, subvencione, kredi pa interes për blerje të pajisjeve android, tableta etj; të gjitha këto në funksion të lehtësimit të kryerjes së mësimin online në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme. Mungesa e këtyre lehtësirave është evidentuar në të gjitha IAL-et dhe shoqërohet me një qëndrim pasiv të Njësive të Vetëqeverisjes vendore (bashkitë), të cilat nuk kanë afruar asnjë ndihmë apo lehtësi për studentët. Përgjegjësi mban dhe MASR e cila nuk ka marrë asnjë iniciativë për marrëveshje me kompani private celulare apo për shpërndarje të internetit, për tarifa lehtësuese, aparate telefoni apo WIFI falas, etj.

Rekomandimi 8. IAL-et nëpërmjet Konferencës së Rektorëve dhe Senateve akademike, t'i kërkojnë MAS që të ndërmarrë iniciativa për të kryer marrëveshje me Bashkitë dhe kompani të ndryshme shërbimesh publike që të ndikojnë dhe përmirësojnë jetën e studentëve, duke kërkuar vënien në eficiencë të Kartës së Studentit. Të gjejë gjithashtu zbatim efikas përfitimi i shërbimeve me tarifa lehtësuese për studentët, si në kohë normale ashtu dhe në situata të jashtëzakonshme.

Konstatohet se: Gjatë vitit akademik 2022 – 2023, të gjithë studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës janë pajisur me kartën e studentit, nëpërmjet të cilës studentët kanë përfituar avantazhe, tarifa të reduktuara dhe oferta të dedikuara si nga institucionet publike ashtu dhe nga subjektet private (rreth 1000 shërbime).

Universiteti Politeknik i Tiranës ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë me Bashkinë e Tiranës për realizimin e procesit të informimit dhe orientimit të studentëve lidhur me pajisjen me Kartën e Studentit, proces i cili pritet të realizohet në datat e para të fillimit të vitit akademik 2023 – 2024. Gjithashtu, në cilësinë e anëtarit, UPT angazhohet të adresojë këtë rekomandim pranë Konferencës së Rektorëve dhe do të vijojë të ofrojë gadishmërinë me qëllim realizimin e tij.

Për sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet i realizuar.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UPT, vlerësohet se është pranuar si rekomandim dhe zbatuar. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

-UNIEL

Konstatohet se: Lidhur me këtë rekomandim, Senati Akademik, iu përmbajt mendimit, se UNIEL, në kuadrin e marrëveshjeve me njësitë e qeverisjes vendore, të paraqiten tërësia e tarifave

lehtësuese për studentët, me qëllimin që të bëhet efiçiente karta e studentit në nivel rajonal. UNIEL ka vendosur përdorimin e unifikuar të sistemit digital të mësimi në distancë. Në vazhdimësi do të thellojnë njohuritë mbi bazën e dokumentacionit, rekomandimeve dhe praktikave të BE-së lidhur me përdorimin e programeve të e-learning.

Stafi akademik ka marrë asistencë teknike në mënyrë të vazhdueshme nga specialist të IT, punojnë në UNIEL-it për të përkthyer përdorimin e programeve. Po kështu specialistet e IT nepermjet programeve të ndryshme ndërrpruese kanë arritur t'u japin asistencë teknike të gjithë studentëve të cilët hasen problematika në logimin si dhe në përdorim të programeve.

Nga eksperiencia e fituar përgjate periudhes se pandemise, UNIEL me qëllim thellimin e njohurive mbi dokumentat dhe praktikën e mira të e-learning, do të jetë periodikisht e angazhuar për perfeksionimin në rritje të procesit mesimor e kërkimor.

Po kështu janë rifreskuar marrëveshjet me disa bashki të Qarkut Elbasan dhe me subjekte të ndryshme të biznesit. Kemi rikërkuar Bashkisë Elbasan për të emetuar kartën e studentit për të krijuar lehtësira në shërbimet ndaj tyre.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UNIEL, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces pasi ka shtrirje kohore në vijimësi.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi .

-UNIKO

Konstatohet se: Lidhur me këtë rekomandim, Senati Akademik, iu përmbajt mendimit, se UKorçë, në kuadrin e marrëveshjeve me njësitë e qeverisjes vendore, të parashkruhen tërësia e tarifave lehtësuese për studentët, me qëllimin për ta bërë efiçiente kartën e studentit në nivel rajonal.

Nga eksperiencia e fituar përgjate periudhes se pandemise, UNIKO me qëllim thellimin e njohurive mbi dokumentet dhe praktikën e mira të e-learning, do të jetë periodikisht e angazhuar për perfeksionimin në rritje të procesit mesimor e kërkimor.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UKorçë, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces pasi ka shtrirje kohore në vijimësi.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi .

-UGJ

Konstatohet se: Lidhur me këtë rekomandim, Senati Akademik, iu përmbajt mendimit, se UGJ-ja në kuadrin e marrëveshjeve me njësitë e qeverisjes vendore, të parashkruhen tërësia e tarifave lehtësuese për studentët, me qëllimin për ta bërë efiçiente kartën e studentit në nivel rajonal.

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjrokaštër vendosi përdorimin e unifikuar të sistemit digital të mësimi në distancë. Në vazhdimësi në do të thellojmë njohuritë mbi bazën e dokumentacionit, rekomandimeve dhe praktikave të BE-së lidhur me përdorimin e programeve të e-learning.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UGJ, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi .

-UNVlorë

Konstatohet se: Lidhur me këtë rekomandim, Senati Akademik, iu përmbajt mendimit, se UV, në kuadrin e marrëveshjeve me njësitë e qeverisjes vendore, të parashkruhen tërësia e tarifave lehtësuese për studentët, me qëllimin për ta bërë efiçiente kartën e studentit në nivel rajonal.

UVlorë ka vendosur përdorimin e unifikuar të sistemit digital të mësimin në distancë. Në vazhdimësi do të thellohen njohuritë mbi bazën e dokumentacionit, rekomandimeve dhe praktikave të BE-së lidhur me përdorimin e programeve të e-learning.

Stafi akademik ka marrë asistencë teknike në mënyrë të vazhdueshme nga specialist të IT, punonjës së UVlorë përse i përket përdorimit të programeve. Po kështu specialistet e IT nepermjet programeve te ndryshme ndërvepruese kanë arritur t'u japin asistencë teknike te gjithë studentëve të cilët hasen problematika në logimi si dhe në përdorim të programeve si dhe kanë kërkuar shtesë fondesh dhe me shkresën nr.1144/5 Prot., datë 07.07.2023 "Përcjellje kërkesa buxhetore për paisje e sisteme IT".

Nga eksperiencia e fituar pergjate periudhes se pandemise, U Vlorë me qellim thellimin e njohurive mbi dokumentet dhe praktikat e mira te e-learning, do të jetë periodikisht e angazhuar për perfeksionimin në rritje të procesit mesimor e kërkimor.

Kemi rikërkuar Bashkisë Vlorë për të emetuar kartën e studentit për të krijuar lehtësira në shërbimet ndaj tyre.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UVlorë, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces pasi ka shtrirje kohore në vijimësi.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi .

Për pyetjen audituese: 1.1.2. A i ka shërbyer ky kuadër arritjes së objektivave të mësimëdhënies, kërkimit shkencor dhe mbrojtjes së shëndetit të studentëve dhe stafit akademik?

Gjetja nga auditimi: 9. Në asnjë rast nuk është hartuar dhe miratuar rrjedha e dokumentuar e aktiviteteve (nga fillimi deri në përfundim të tyre) që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to, sa i takon procesit mësimor online (distancë) dhe auditor në periudhën e pandemisë 2020-2021, konkretisht:

- monitorimi i orëve të mësimin, është bazuar tek vetdeklarimi i secilit pedagog pas zhvillimit të procesit mësimor, që raportohej çdo javë pranë Drejtorisë së Kurrikulave të IAL-eve, informacion të cilin e kanë përcjellë në MASR.

- u konstatuan paqartësi nga studentët dhe pedagogët në lidhje me adresimin e ankesave gjatë periudhës së pandemisë dhe në asnjë rast nuk është hartuar gjurma e auditimit për trajtimin e ankesave, kjo në kundërshtim me nenin 16, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

Rekomandimi 9: "Rektorati dhe Senati akademik të (IAL-eve) të marrin masa për hartimin dhe miratimin e gjurmës së auditimit për monitorimin e mësimin dhe trajtimin e ankesave, dhe dokumentacioni dhe të dhënat të jenë në formë të tillë që t'u mundësojë audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit e të japin siguri objektive mbi auditimin e kryer".

-UPT

Konstatohet se: Zhvillimi i mësimin online u diktua nga situata e jashtëzakonshme pasi kjo formë mësimëdhënie nuk parashikohet në legjislacionin në fuqi. Megjithatë UPT ka hartuar një udhëzues për mësimin në distancë, i cili parashikon procedurat dhe mënyrat e kontrollit të kësaj forme të zhvillimit të procesit mësimor. Gjithashtu, janë marrë masa për ngritjen e një sistemi kontrolli të brendshëm me mekanizma eficientë për verifikimin e orëve të mësimin dhe adresimit të ankesave në hierarkinë ekzistuese nga lart poshtë, si dhe do të ketë në vëmendje që në situata të tilla të ngjashme dhe të jashtëzakonshme, të miratojë gjurmën e auditimit për monitorimin e mësimin dhe trajtimin e ankesave në përputhje me Rekomandimet e KLSH-së.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UPT, vlerësohet se është pranuar si rekomandim dhe është zbatuar. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

UNIEL

të kuptojnë mjedisin e kontrollit e të japin siguri objektive mbi auditimin e kryer”.

Konstatohet se: Institucioni, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe udhëzimin përkatës të ministrisë përgjegjëse për arsimin ka përcaktuar ngarkesën mësimore për personelin akademik. Monitorimi i ngarkesës mësimore, në aspektin sasior dhe cilësor, realizohet përmes rregullores së UNIEL-it, rregulloreve të njësive dhe rregulloreve të programit të studimit.

Lidhur me këtë rekomandim Senati Akademik, u ka lënë detyrë të gjitha strukturave përkatëse të universitetit, që të marrin masat e nevojshme për rishikimin e akteve rregullatore. Rregullorja e UNIEL shprehet për monitorimin e procesit mësimor përmes plotësimit të regjistrit të petagogut, i cili duhet të jetë si shtojcë e rregullores. Regjistri është dokument zyrtar përmes së cilit drejtuesit e departamenteve monitorojnë zhvillimin e procesit mësimor. Ky dokument si dhe analizat në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe institucioni për cilësinë e procesit mësimor dhe trajtimin e ankesave të personelit akademik, të cilat shprehen përmes akteve rregullatore, raporteve dhe vendimmarrjeve, janë dokumente edhe në shërbim të monitorimeve, të brendshme dhe të jashtme. Ky korpus dokumentash, të jenë të depozituara në njësitë përkatëse.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UNIEL, vlerësohet se është pranuar si rekomandim dhe është zbatuar. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar .

-UNIKO

Konstatohet se: Janë marrë masa për ngritjen e një sistemi kontrolli të brendshëm me mekanizma eficientë për verifikimin e orëve të mësimit dhe adresimit të ankesave në hierarkinë ekzistuese nga lart poshtë. Sektori auditiv të brendshëm po ndjek e kontribon në ngritjen e një sistemi të brendshëm dhe janë duke u marrë masa për zbatimin e tyre dhe ngritjen e sistemit të brendshëm.

Lidhur me këtë rekomandim Senati Akademik, u ka lënë detyrë të gjitha strukturave përkatëse të universitetit, që të marrin masat e nevojshme për rishikimin e akteve rregullatore. Rregullorja e UNIKO shprehet për monitorimin e procesit mësimor përmes plotësimit të regjistrit të pedagogut, i cili duhet të jetë si shtojcë e rregullores.

Universiteti “Fan S Noli” Korçë”, ka marrë masa paraprake për rishikimin e procedurave dokumentare në përputhje me rekomandimin e derguar nga KLSH, për hartimin dhe miratimin e gjurmës së auditimit për monitorimin e mësimit dhe trajtimin e ankesave.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UKorçë, vlerësohet se është pranuar si rekomandim dhe është zbatuar. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar .

-UGJ

Konstatohet se: Monitorimi i ngarkesës mësimore, në aspektin sasior dhe cilësor, realizohet përmes rregullores së UGJ-së, rregulloreve të njësive dhe rregulloreve të programit të studimit.

Lidhur me këtë rekomandim Senati Akademik, u ka lënë detyrë të gjitha strukturave përkatëse të universitetit, që të marrin masat e nevojshme për rishikimin e akteve rregullatore. Ky dokument si dhe analizat në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe institucioni për cilësinë e procesit mësimor dhe trajtimin e ankesave të personelit akademik, të cilat shprehen përmes akteve rregullatore, raporteve dhe vendimmarrjeve, janë dokumente edhe në shërbim të monitorimeve, të brendshme dhe të jashtme.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UGJ, vlerësohet se është pranuar si rekomandim dhe është zbatuar. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar .

UVlorë

Konstatohet se: Janë marrë masa për ngritjen e një sistemi kontrolli të brendshëm me mekanizma eficientë për verifikimin e orëve të mësimit dhe adresimit të ankesave në hierarkinë ekzistuese nga lart poshtë. Sektori auditit të brendshëm po ndjek e kontribon në ngritjen e një sistemi të brendshëm dhe janë duke u marrë masa për zbatimin e tyre dhe ngritjen e sistemit të brendshëm. Institucioni, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe udhëzimin përkatës të ministrisë përgjegjëse për arsimin përcakton ngarkesën mësimore për personelin akademik.

Rregullorja e UV shprehet për monitorimin e procesit mësimor përmes plotësimit të regjistrit të pedagogut, i cili duhet të jetë si shtojcë e rregullores. Në këtë regjistrë të shprehen orët e zhvilluara në auditor (temat, datat dhe nënshkrimi i titullarit/asistentit) të miratuara nga përgjegjësi i njësisë bazë përkatëse. Regjistri është dokument zyrtar përmes së cilit drejtuesit e departamenteve monitorojnë zhvillimin e procesit mësimor. Ky dokument si dhe analizat në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe institucioni për cilësinë e procesit mësimor dhe trajtimin e ankesave të personelit akademik, të cilat shprehen përmes akteve rregullatore, raporteve dhe vendimmarrjeve, janë dokumente edhe në shërbim të monitorimeve, të brendshme dhe të jashtme.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UVlorë, vlerësohet se është pranuar si rekomandim dhe është zbatuar. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statuti i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar .

Gjetja nga auditimi: 10. Nga auditimi u konstata se departamentet e IAL-ve nuk kanë bërë analiza të nevojave në lidhje me kapacitetet që duhet të kenë klasat virtuale, me qëllim funksionimin real dhe pa problem të tyre, për nevojat lidhur për punët laboratorike si dhe studim apo analizë mbi gjendjen e infrastrukturës dixhitale për të njohur kapacitetin e nevojshëm për shkarkimin e leksioneve, detyravë të kursit, projekteve, etj. Mungesa e evidentimit të problematikave të mësipërme, ka sjellë si pasojë aplikimin nga universitetet objekt auditimi të disa platformave (shpesh të përzgjedhura individualisht nga pedagogët), si Google-classroom, Microsoft Teams dhe Zoom, të cilat nisur edhe nga përgjigjet e pyetësorëve paraqitën problematika teknike në lidhje me internetin dhe aksesimin e këtyre platformave.

Rekomandimi 10: “IAL-të të marrin masa dhe në periudha periodike të kryejnë me grup pune vlerësimin e gjendjes së infrastrukturës së IT, kapaciteteve dhe mundësive për situata të jashtëzakonshme dhe të pa parashikuara”.

-UPT

Konstatohet se: Universiteti Politeknik i Tiranës ka tashmë një platformë të unifikuar në të gjitha njësitë kryesore të cilat kanë rezultuar mjaft të suksesshme dhe pa kosto shtesë, ose me kosto të ulët për zhvillimin e mësimit online në periudha të jashtëzakonshme. Ndërkohë, në mënyrë të vazhdueshme ka investuar për blerjen e pajisjeve kompjuterike dhe audiovizuale të cilat i shërbejnë këtij qëllimi.

Lidhur me këtë rekomandim, gjatë pandemisë u fitua një eksperiencë për zhvillimin e mësimit në auditore/laboratore edhe online, duke vënë në eficiencë infrastrukturën ekzistuese. UPT do të përshtasë me të gjitha kapacitetet që ka, zhvillimin e procesit mësimor në rastet që do të ndeshet me situata apo gjendje të jashtëzakonshme. Për sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet i realizuar.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UPT, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

-UNIEL

Konstatohet se: Lidhur me këtë rekomandim, Senati Akademik konstaton se infrastruktura për zhvillimin e procesit mësimor-kërkimor, është e mirëmenaxhuar. Me rastin e pandemisë u fitua një eksperiencë për zhvillimin e mësimin në audotore/laboratore dhe online, duke vënë në eficiencë infrastrukturën e pasur. Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" ka marrë masa për rivlerësimin e kapaciteteve të IT. Gjatë vitit 2022 u fitua projekti AKKSHI për infrastrukturën kërkimore me objekt: "Krijim softë dhe blerje pajisje 'Dixhitalizimi i burimeve bibliotekare në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"'. Biblioteka e UE-së, grumbullon, përpunon, ruan dhe vë në shërbim të përdoruesve, materiale bibliotekare në përshtatje me kërkesat arsimore, shkencore dhe kulturore të tyre. Misioni i saj është mbështetja e procesit mësimor, edukativ dhe shkencor, duke u shërbyer studentëve, personelit akademik dhe administrativ të Universitetit ashtu edhe kërkuesve shkencorë të këtij Institucioni. UNIEL do të përshtasë me të gjitha kapacitetet mbi kompesimin apo humbjen e të drejtave të zhvillimit të procesit mësimor në momentet që do të ndeshet me situata apo gjendje të jashtëzakonshme.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UNIEL, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

-UNIKO

Konstatohet se: Çdo vit MAS kryen pranë institucionit verifikimin e kapaciteteve pritëse ku përfshihet dhe infrastruktura e IT. Në vijimësi do të kihet parasysh që grupet e vlerësimit të infrastrukture pritëse të parashikojnë kapacitete dhe infrastrukturë dhe për situata të jashtëzakonshme.

Lidhur me këtë rekomandim, me rastin e pandemisë u fitua një eksperiencë për zhvillimin e mësimin në audotore/laboratore dhe online, duke vënë në eficiencë infrastrukturën e pasur. Universiteti i Korçës ka marrë masa për rivlerësimin e kapaciteteve të IT. Institucioni. UK do të përshtasë me të gjitha kapacitetet mbi kompesimin apo humbjen e të drejtave të zhvillimit të procesit mësimor në momentet që do të ndeshet me situata apo gjendje të jashtëzakonshme.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UV, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

-UEGJ

Konstatohet se: Lidhur me këtë rekomandim, Senati Akademik konstatoi se infrastruktura për zhvillimin e procesit mësimor-kërkimor, është e mirëmenaxhuar. Me rastin e pandemisë u fitua një eksperiencë për zhvillimin e mësimin në audotore/laboratore dhe online, duke vënë në eficiencë infrastrukturën e pasur. Me tej, Rektorati la për detyrë se kjo eksperiencë duhet të zhvillohet përmes formalizimit të plotë dhe korrekt. Lidhur me modalitetet, krahas rregulloreve të UGJ-së dhe të njëjve kryesore, duhet të shprehen edhe rregulloret e veçanta, në rastet e pandemive.

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokaster do të përshtasë me të gjitha kapacitetet mbi kompesimin apo humbjen e të drejtave të zhvillimit të procesit mësimor në momentet që do të ndeshet me situata apo gjendje të jashtëzakonshme.

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër, për përmirësimin e mësimdhënies në bashkëpunim me AKSHI -in, i cili na ka vënë në dispozicion fonde, ka ngritur 6 (gjashtë) klasa dixhitale si dhe një

laborator për mësimdhënien, për tju ardhur në ndihmë studentëve, jo vetëm në situatë normale, por edhe gjatë gjëndjeve të jashtëzakonshme.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UGJ, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin, por ky rekomandim është në proces, pasi duhet të vazhdojë zbatimi dhe për IAL-et dhe Bashkitë e Qarkut Gjirokastrë. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi .

UNVlorë

Konstatohet se: Lidhur me këtë rekomandim, UV ka ngritur grupin e punës për vlerësimin e gjëndjes së infrastrukturës së IT për situatë të jashtëzakonshme dhe të pa parashikuara. Administratori, me urdhrin nr.9 datë 07.02.2023 e me nr.241 prot., datë 07.02.2023, ka ngritur grup pune për inventarizimin e aktiveve të institucionit për vitin 2023, bazuar në relacionin e komisionit të inventarizimit do të vlerësohet dhe gjendja e infrastrukturës së IT për situatë të jashtëzakonshme dhe të parashikuara, process që po punohet nga UV. Zyra IT ka bërë kërkesë me anë të kërkesave buxhetore, për trajnim dhe implementim të platformes Active Directory për menaxhim me efikas dhe parandalimin e rreziqeve që mund të vijnë nga situatë të parashikuara në lidhje me struktura IT të Universitetit të Vlorës. Senati Akademik ka konstatuar se infrastruktura për zhvillimin e procesit mësimor-kërkimor, është e mirëmenaxhuar. Me rastin e pandemisë u fitua një eksperiencë për zhvillimin e mësimin në audotore/laboratore dhe online, duke vënë në eficiencë infrastrukturën e pasur. Universiteti i Vlorë ka marrë masa për rivlerësimin e kapaciteteve të IT. Institucioni.UEL do të përshtasë me të gjitha kapacitetet mbi kompesimin apo humbjen e të drejtave të zhvillimit të procesit mësimorë në momentet që do të ndeshet me situatë apo gjendje të jashtëzakonshme.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UV, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

Gjetja nga auditimi: 11. Nga IAL-et objekt auditimi, janë përdorur fonde nga buxheti që kanë patur si burim rialokimet e kryera dhe buxheti i përdorur nga këto universitete, në përqindje fare të vogël, më pak se 1% nga buxheti total i përdorur në këtë periudhë pandemie për mbrojtjen e shëndetit dhe zbatimin e kushteve higjieno-sanitare të mësimdhënies studentëve (online/auditorë) dhe stafit akademik e administrativ në situatën e pandemisë në vitet 2020-2021. Nuk janë përdorur fondet në dispozicion që kishin IAL-et, për të alokuar nga shpenzimet e tjera vlera më të mëdha me prioritet fondet për pandeminë në investime, infrastrukturën e IT dhe ndihmë për studentët, 20-30% e fondeve buxhetore të tyre, të “digjeshin” dhe të mos përdreshin.

Rekomandimi 11: “IAL-et të marrin masa e të bashkëpunojnë me Senatet Akademike e Bordet e Administrimit, për nevojat e vendimmarrjeve në vlerësimin e situatave që mund të paraqiten (veçanërisht në kushte të jashtëzakonshme), shfrytëzimin e të gjitha mundësive për rialokime fondesh, dhe të hartohen plane veprimi për përmirësimin dhe lehtësimin e mësimin në auditorë apo dhe në distancë nga studentët e stafit akademik”.

UPT

Konstatohet se: Në Universitetin Politeknik të Tiranës nuk ka rezultuar e nevojshme vendimmarrja për rialokime fondesh pasi situatë është manaxhuar me kujdes dhe është përballuar duke marrë vendime në përpjestim me nevojat dhe kufizimet e përcaktuara në udhëzimet dhe aktet normative të miratuara nga institucionet përgjegjëse. Mbështetja financiare e studentëve në këto situatë të jashtëzakonshme ku mësimi zhvillohet online dhe lëvizja është e kufizuar, lidhet

drejtëpërdrejtë me politikat ekonomike e sociale të qeversjes së përgjithshme. Në këto raste natyrisht institucioni ynë do të ofrojë mbështetjen teknike dhe kontributin e tij në aspektin organizativ për realizimin e këtyre politikave me ndikim të drejtëpërdrejtë në zhvillimin e procesit mësimor. Në rast se do të shfaqet një situatë e ngjashme në të ardhmen, universiteti angazhohet të analizojë nevojat dhe sipas rastit të hartojë plane veprimi, të marrë vendime në varësi të situatës financiare dhe udhëzimeve të institucioneve qendore përgjegjëse. Për sa më sipër, ky rekomandim është zbatuar.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UPT, vlerësohet se është pranuar si rekomandim dhe trajtohet i bazuar, për shkak se nuk ka patur nevoja riallokimi fondesh. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

UNIEL

Konstatohet se: UNIEL në bashkëpunim me Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit në varësi të situatave do të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për të trajtuar dhe zgjidhur situatat që mund të krijohen në të ardhmen. Veçanërisht në kushte të jashtëzakonshme, do të shfrytëzojë të gjitha mundësitë për riallokime fondesh, dhe do të hartojë plane veprimi për përmirësimin dhe lehtësimin e mësimin në auditorë apo dhe në distancë për studentët dhe stafin akademik.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i U, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

UNIKO

Konstatohet se: UKorçë ka vlerësuar gjithë kërkesat dhe propozimet e Rektorit, Njësisë Kryesore dhe Drejtorive për të miratuar riallokime fondesh në organet kolegjiale në mënyrë që të përgjigjet në kohë dhe me efektivitet situatave të jashtëzakonshme. Në vijimësi Administratori në bashkëpunim me organet kolegjiale do të vlerësojnë dhe do të marrin masa për shfrytëzimin e mundësive për riallokim fondesh dhe do të hartojnë plan veprime për tu përshtatur me situatat e jashtëzakonshme.

UKorçë në bashkëpunim me Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit në varësi të situatave do të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për të trajtuar dhe zgjidhur situatat që mund të krijohen në të ardhmen. Veçanërisht në kushte të jashtëzakonshme, do të shfrytëzojë të gjitha mundësitë për riallokime fondesh, dhe do të hartojë plane veprimi për përmirësimin dhe lehtësimin e mësimin në auditorë apo dhe në distancë për studentët dhe stafin akademik.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UKorçë, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

UGJ

Konstatohet se: Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë në bashkëpunim me Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit në varësi të situatave do të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për të trajtuar dhe zgjidhur situatat që mund të krijohen në të ardhmen. Veçanërisht në kushte të jashtëzakonshme, do të shfrytëzojë të gjitha mundësitë për riallokime fondesh, dhe do të hartojë plane veprimi për përmirësimin dhe lehtësimin e mësimin në auditorë apo dhe në distancë për studentët dhe stafin akademik.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UGJ, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

UVlorë

Konstatohet se: UVlorë ka vlerësuar gjithë kërkesat dhe propozimet e Rektorit, njërive kryesore dhe drejtorive për të miratuar rialokime fondesh në organet kolegjiale në mënyrë që të përgjigjet në kohë dhe me efektivitet situatave të jashtëzakonshme. Në vijimësi Administratori në bashkëpunim me organet kolegjiale do të vlerësojnë dhe do të marrin masa për shfrytëzimin e mundësive për rialokim fondesh dhe do të hartojnë plan veprime për tu përshtatur me situatat e jashtëzakonshme.

UVlorë në bashkëpunim me Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit në varësi të situatave do të ndër marrë hapa të menjëhershëm për të trajtuar dhe zgjidhur situatat që mund të krijohen në të ardhmen. Veçanërisht në kushte të jashtëzakonshme, do të shfrytëzojë të gjitha mundësitë për rialokime fondesh, dhe do të hartojë plane veprimi për përmirësimin dhe lehtësimin e mësimin në auditorë apo dhe në distancë për studentët dhe stafin akademik.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UVlorë, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

Gjetja nga auditimi: 12. Universiteti Politeknik i Tiranës për periudhën e vitit të pandemisë 2020 në përmbushje të detyrimit për kryerjen e shërbimeve ndaj studentëve, ka evidentuar kohë pune jashtë kohës normale të punës për punonjësit e sekretarive arsimore, të cilët në kushte pandemie janë urdhëruar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve që të punojnë jashtë orarit për shkak të regjistrimeve të studentëve, ndërkohë që kjo pagesë është bllokuar nga Dega e Thesarit Tiranë me pretendimin se pagesa e orëve jashtë orarit të kryera nga punonjësit e Universitetit Politeknik të Tiranës apo institucioneve të pavarura, duhet të bëhet pas miratimit nga ministria përgjegjëse për financat. Bazuar në Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe autonominë financiare e organizative, nuk duhet të pengohen për veprime financiare me të ardhurat konform procedurave ligjore.

Rekomandimi 12. Universiteti Politeknik i Tiranës, të marrë masa dhe nëpërmjet vendimmarrjeve të strukturave drejtuese akademike dhe administrative, të bashkëpunojë me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve dhe Ministrinë e Financave, për të gjetur zgjidhjen e problemit dhe kryerjen e pagesave të papaguara, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

UPT

Konstatohet se: Pas një korrespondence shkresore të vazhdueshme me MF dhe DAP, me gjithë mbështetjen e vazhdueshme të MAS, nuk u arrit të veprohej sipas përcaktimeve të autonomisë që parashikon legjislacioni për arsimin e lartë lidhur me pagesën e orëve shtesë të kryera nga personeli UPT. Në këto kushte, për të mos vonuar më tej procesin u ndoqën procedurat e diktuar nga MFE dhe DAP për kryerjen e pagesave jashtë orarit të sekretarive mësimore për vitin akademik 2021 - 2022. Me miratimin nga Këshilli i Ministrave të vendimit nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, institucionet e arsimit të lartë publik nuk janë përfshirë në fushën e zbatimit të këtij akti.

Me miratimin e këtij akti, institucioneve të arsimit të lartë i hapet rrugë kryerjes së pagesave të miratuara nga organet kolegjiale drejtuese, pa qenë e nevojshme marrja e miratimeve paraprake nga institucionet si MFE apo DAP. Për sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UPT, vlerësohet se është pranuar si rekomandim e zbatuar. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

Gjetja nga auditimi: 13. Nga auditimi është konstatuar se problematika e kapaciteteve infrastrukturore është përkeqësuar në kushtet e pandemisë së Covid-19, duke marrë në konsideratë se për zhvillimin e lirshëm të aktivitetit institucional, ka lindur nevoja për dyfishin e kapaciteteve, nisur nga rregullat për distancimin social dhe shfrytëzimin e një pjese të ambienteve si qendra vaksinimi etj., fakt i cili rezulton se e ka vënë në vështirësi UPT-në, i cili për shkak të problematikave të pronësisë dhe rrjedhimisht pasigurisë juridike të krijuar, ka hasur pengesa në marrjen e lejeve të nevojshme për kryerjen e investimeve në infrastrukturën ndërtimore. UPT gjatë periudhës së pandemisë ka patur probleme me kufizimin e sipërfaqes për auditorë, pra në disa fakultete si Arkitektura, Urbanistika, FTIE etj., nuk është respektuar distanca dhe masat e tjera të caktuara nga Komiteti i Ekspertëve, situatë kjo e shkaktuar nga dëmtimet e pësuar në dy godina kryesore nga lëkundjet sizmike të vitit 2019, prej faktit se ky IAL ka qënë i kufizuar në kryerjen e investimeve. UPT nuk i ka në pronësi 27 prona dhe institucionet nuk lejojnë që të parashikojë apo ndërhyjë me investime apo përshtatje sipas kërkesave. Mungesa e VKM për të miratuar listën e inventarit dhe kalimin në pronësi të këtyre pronave pengon zhvillimin e aktivitetit të UPT-së. Kjo, bazuar në Ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar dhe sipas nenit 15 pika 1/3 e VKM-së nr. 408 dt. 13.05.2015 "Rregullorja e zhvillimit të territorit" në dukumente pika 2 kërkohej: " *...Dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet midis pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta...* " nuk e lejon të kryhet investim nëse objektet nuk janë në pronësi.

Faktor tjetër ka qenë dhe mungesa e financimit nga buxheti i shtetit për objektet e dëmtuara nga tërmeti, në veçanti Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, ka sjellë vështirësi në plotësimin e hapësirave të nevojshme për studentët gjatë pandemisë dhe në vijim

Rekomandimi 13. Autoritetet dhe organet drejtuese të Universitetit Politeknik të Tiranës të marrin masa në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Agjensisë Shtetërore të Kadastrës dhe institucione të tjera përgjegjëse, për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe propozimin për vendimmarrje në Këshillin e Ministrave dhe miratimin e "Listës së pronave ose përgjegjësi administrimi të Universitetit Politeknik të Tiranës". Kjo situatë të adresohet në nivelet më të larta vendimmarrëse të qeverisë, e cila ka detyrimin ligjor të sigurojë fondet e nevojshme nga buxheti i shtetit për përmirësimin infrastrukturor dhe zhvillimin e pronave, të domosdoshme për zgjerimin dhe plotësimin e kapaciteteve infrastrukturore, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë për Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë.

UPT

Konstatohet se: Universiteti Politeknik i Tiranës aktualisht është duke ndjekur procedurat pranë ASHK-së për saktësimin e të dhënave për disa nga objektet që gjatë procesit të shqyrtimit përpara kalimit në Këshillin e Ministrave kanë rezultuar më problematike.

Lista e objekteve është paraqitur pranë MAS me qëllim vijimin e procedurave të miratimit por problematikat e konstatuara kanë shtruar nevojën e saktësimit dhe plotësimit të dokumentacionit pranë ASHK proces i cili është duke u kryer nga UPT.

Në zbatim të këtij rekomandimi, UPT ka vijuar dhe po vijon procesin për inventarizimin dhe kalimin në përgjegjësi administrimi të pronave të paluajtshme shtetërore në të cilat zhvillon aktivitetin institucional, duke komunikuar zyrtarisht, si dhe aplikuar online dhe në formë shkresore sipas procedurave ligjore pranë institucioneve përgjegjëse ASHK dhe MAS.

Lidhur me përmirësimin e infrastrukturës për zgjerimin dhe plotësimin e kapaciteteve infrastrukturore, në buxhetin e shtetit të vitit 2023, janë parashikuar fondet për rindërtimin/rikonstruksionin e dy objektet e dëmtuara nga tërmeti dhe konkretisht Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave.

Në vitin 2023, janë financuar nga buxheti i shtetit 250.000 mijë lekë për rindërtimin e godinës së Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe 85.000 mijë lekë për rikonstruksionin e Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave. Për sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UPT, vlerësohet se është pranuar si rekomandim e po punohet për zbatimin e këtij rekomandimi. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe proces zbatimi..

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi.

Gjetja nga auditimi: 14. Konstatuam se sektori i Auditit të Brendshëm në Universiteti Politeknik Tiranë, nuk ka funksionuar sipas kërkesave ligjore dhe për qëllimin e krijuar, pasi: (i) ka munguar vendimmarrja dhe angazhimi i Bordit të Administrimit në monitorimin dhe në mbështetjen e veprimtarisë së këtij sektori; si dhe nuk janë zbatuar planet e auditimit të miratuara në fillim vitit 2020-2021 dhe nuk janë evaduar materialet sipas kërkesave të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Në UPT, nuk është bërë vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas nenit 20, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe nuk është krijuar mjedisi i duhur i kontrollit të brendshëm për vlerësim nga struktura e Auditit të Brendshëm në Universitetin Politeknik Tiranë.

Rekomandimi 14. Bordi i Administrimit dhe autoritetet drejtuese Rektor/Administrator në Universiteti Politeknik të Tiranës, të marrin masa, të rrisin bashkëpunimin për të marrë vendimet e nevojshme sipas fushës së përgjegjësisë, për të kthyer në funksionimin normal të Sektorit të Auditimit të Brendshëm. Të miratojnë menjëherë planet vjetore dhe afatmesme të auditimit, si dhe të përcaktojnë mënyrën e raportimit dhe modalitetet administrative të koordinimit dhe informimit të dy autoriteteve drejtuese të IAL-së (Rektor/Administrator).

UPT

Konstatohet se: Veprimtaria e Sektorit të Auditimit të Brendshëm ka vijuar të funksionojë normalisht pasi janë miratuar planet vjetore dhe afatmesme dhe është vendosur një raport korrekt komunikimi dhe bashkëpunimi me autoritetet drejtuese.

Me Vendimin nr. 39, datë 15.12.2022 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e planit strategjik dhe vjetor të auditit të brendshëm në Universitetin Politeknik të Tiranës për periudhën 2023 – 2025”, janë miratuar plani strategjik dhe vjetor, si dhe me vendimet nr. 7 dhe nr. 8 datë 15.03.2023 janë miratuar raportet përfundimtare të auditimit në Fakultetin Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, si dhe në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, të cilat i janë dërguar autoriteteve drejtuese (Rektor/Administratori). Ndërkohë vijon normalisht angazhimi i auditimit të brendshëm i parashikuar në njësitë e rradhës. Raportimi dhe komunikimi me autoritetet drejtuese është realizuar në formë shkresore për të gjitha aktet e miratuara dhe problematikat e konstatuara gjatë auditimeve të realizuara. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UPT, vlerësohet se është pranuar si rekomandim e zbatuar. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

Gjetja nga auditimi: 15. Është konstatuar se përcaktimi në VKM i pagesës së anëtareve të Senatit akademik është kryer si pagë mujore dhe jo në bazë të mbledhjeve, gjë e cila ka rënduar buxhetin

e IAL-eve, pasi për shkak të numrit të lartë të anëtarëve të këtyre organeve në veçanti të Senatit akademik, shpenzimet për pagesën e tyre janë të konsiderueshme. Bordi i Administrimit të IAL-eve dhe stafi drejtues, nuk i kanë përdorur kompetencat që u jep ligji organik për autonominë financiare dhe organizative për të rishikuar pagesat e senatit akademik si gjatë pandemisë, por dhe para saj për rishikimin e pagesave të anëtarëve të Senatit akademik sipas VKM nr. 656, datë 31.10.2018 “Për caktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore”, pika 5, ku citohet: “*Kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në senatin akademik dhe bordin e administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj*”, pra të kishte një vlerësim në ulje dhe të vendosej Këto pagesa në kufirin maksimal prej 25,000 lekë/muaj, janë kryer në të pesë Universitetet objekt auditimi.

Rekomandimi 15. Strukturat drejtuese të IAL-eve bazuar në kompetencat që u njeh autonomia financiare dhe organizative, të rivlerësojnë dhe rishikojnë mundësitë e vendimmarrjes për pagesë më të ulët pagese, si dhe duke kufizuar numrin e mbledhjeve të pagueshme, në maksimalisht 9 mbledhje në vit.

UPT

Konstatohet se: Pagesat e anëtarëve të Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik kryen në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 656 datë 31.10.2018 “Për Përcaktimin e Masës së Shpërblimit të Anëtarëve të Këshillave, Bordeve ose Komisioneve të Përhershme të njësive të Qeverisjes Vendore”. Sipas këtij akti për anëtarët e organeve kolegjiale Senat Akademik dhe Bord i Administrimit pagesa është mujore dhe jo në bazë të numrit të mbledhjeve.

Përcaktimi masës dhe mënyrës së pagesës është atribut i vendimmarrjes së qeverisjes së përgjithshme e cila ka nxjerrë aktin nënligjor, por duhet mbajtur në konsideratë se në kushte të zakonshme, masa e shpërblimit është e lidhur ngushtë me politikat e pagave të qeverisë të cilat në arsimin e lartë dhe sektorët e tjerë të administratës publike, gjatë këtij viti kanë pësuar rritje të ndjeshme. Në zbatim të këtij rekomandimi, Bordi i Administrimit ka shprehur parimisht dakordësinë për rishikimin dhe rivlerësimin e masës së pagesës për anëtarët e organeve drejtuese në raste të përsëritjes së një situate të jashtëzakonshme. Për sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet i realizuar pjesërisht, pra në proces pasi nuk ka vendimarrje për pagesat e anëtarëve.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UPT, vlerësohet se është pranuar si rekomandim dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

UNIEL

Konstatohet se: Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” i ka kërkuar Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit që të rishikojmë e rivlerësojmë pagesat e vlerës mujore ose numrit të muajve. Ky rekomandim është pranuar, por nuk ka vendimarrje, pra është në proces zbatimi. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UNIEL, vlerësohet se është pranuar si rekomandim dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

UNIKO

Konstatohet se: Është përcjellë në organet kolegjiale të UKorçë dhe nuk ka vendimarrje lidhur me mundësitë e vendimmarrjes për pagesë më të ulët, si dhe duke kufizuar numrin e mbledhjeve të pagueshme. Ky rekomandim është pranuar, por nuk ka vendimarrje, pra është në proces zbatimi. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues, vlerësohet se është pranuar si rekomandim dhe zbatuar. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe proces zbatimi.

UGJ

Konstatohet se: Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë ka paguar për anëtarët e Bordit të Administrimit shumë prej 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) lekë, sipas vendimit të Bordit të Administrimit nr. 673 Prot., datë 14.05.2018 (vendimi nr. 12), pra nuk ka paguar maksimumin e lejuar sipas VKM nr. 656, datë 31.10.2018 "Për caktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njërive të qeverisjes qendrore", pika 5, ku citohet: *"Kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në senatin akademik dhe bordin e administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj"*.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UGJ, vlerësohet se është pranuar si rekomandim dhe zbatuar. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

UVlorë

Konstatohet se:

Është përcjellë në organet kolegjiale të UVlorë dhe jemi në pritje të vendimarrjes së tyre lidhur me mundësitë e vendimarrjes për pagesë më të ulët pagese, si dhe duke kufizuar numrin e mbledhjeve të pagueshme. Ky rekomandim është pranuar, por nuk ka vendimarrje, pra është në proces zbatimi. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues, vlerësohet se është pranuar si rekomandim dhe zbatuar. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe proces zbatimi.

Gjetja nga auditimi: 16. Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë në kryerjen e aktivitetit të mësimdhënies, kërkimore-shkencore kualifikuese, inovative, si edhe praktikave mësimore e laboratorë në periudhën objekt auditimi 2020 - 2021, nuk administron pasuritë e paluajtshme në pronësi, por i ka ato në përdorim.

Rekomandimi 16: "Drejtuesit e universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të marrin masa dhe të përgatisin dokumentacionin e nevojshëm për të ndjekur procedurat ligjore për kalimin në pronësi të pasurive të paluajtshme që ky institucion ka në inventar"

UGJ

Konstatohet se: Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë i kushtëzuar nga ndalesa që parashikon Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencorë në Republikën e Shqipërisë", neni 117, ku thuhet se: *"Institucionet kanë detyrimin të ruajnë dhe të mirëmbajnë pronat në administrim dhe nuk mund të ndryshojnë destinacionin e tyre. Institucionet mund të zhvillojnë pronat me miratim paraprak të subjektit që i ka kaluar pronën në administrim"* si dhe pronat e paluajtshme, në të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre institucionet publike të arsimit të lartë, që i shërbejnë institucionit për të garantuar përmbushjen e misionit të tij, kalojnë në administrim të institucioneve, me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të ministrit përgjegjës për arsimin. Në këto kushte Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë pret nismën e MAS.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UGJ, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar

zbatimi, por ky rekomandim është në proces, pasi duhet të vazhdojë puna sëbashku me MAS. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi.

Gjetja nga auditimi: 17. Në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” u konstatua se nuk është ngritur struktura e auditimit të brendshëm siç e kërkon zbatimi i Ligji Nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 3, germa “a” dhe ka munguar kontributi i kësaj njësie auditimi në ofrimin e sigurisë së arsyeshme mbi efektivitetin e aktivitetit të vetë universitetit gjatë pandemisë.

Rekomandimi 17. Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” në bashkëpunim me Bordin e Administrimit dhe Senatin, të marrë masa për të filluar procedurat e rekrutimit dhe ngritjes së strukturës së auditimit të brendshëm dhe vënien sa më parë në efencë, duke hartuar e miratuar rregulloren e kësaj njësie auditimi dhe mënyrën e raportimit, modalitetet administrative të kordinimit dhe informimit të dy autoriteteve drejtuese të IAL-së (Rektor/Administrator), mbi problematikat dhe veprimtarinë e auditimit.

UNIEL

Konstatohet se: Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ka punuar me strukturën e miratuar para tre viteve me disa ndryshime. Kemi përgatitur projektstrukturën e re për reformimin e disa njësive bazë, duke ngritur dhe strukturën e Auditit të Brendshëm të institucionit.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UNIEL, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimi. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe proces zbatimi.

Gjetja nga auditimi: 18. Nga auditimi i kryer në zbatimin e kontratave të shërbimeve nga të tretët për ruajtje fizike nga subjekti shtetëror “Ilyrian Guard” të 12 objekteve me polici private, u konstatua se gjatë periudhës së pandemisë (si përgjatë “lockdown” Mars-Prill 2020) por dhe deri në Tetor 2020, nga Bordi i Administrimit në Universitetin e Elbasanit, nuk janë marrë vendime për rishikimin e kontratave referuar kushtit të vendosur në kontratë për gjendje të jashtëzakonshme, për rivlerësimin e kontratave me grupe pune me qëllim uljen e shpenzimeve të panevojshme dhe jo efektive deri në masë 1/3 e tyre dhe rialokimin e tyre me destinacion tjetër, në funksion të mbështetjes së studentëve dhe pedagogëve.

Rekomandimi 18. IAL-et të merren masa dhe të ngrihet grup pune për të rishikuar kontratat për shërbime e sipërmarrje nga të tretët, duke vendosur “shtojcë” të drejtën e rishikimit për rastet e situatave të jashtëzakonshme, me qëllim përdorimin me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.

UNIEL

Konstatohet se: Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ka bërë amendime shtesë për rishikimin e kontratave, sipas situatave. Kemi rishikuar preventivin e ruajtjes fizike të godinave për kontratën e lidhur të vitit 2023 – 2024, duke pakësuar numrin e vëndrojeve me roje fizike dhe shtimin e sistemeve të alarmit.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga stafi drejtues i UNIEL, vlerësohet se është pranuar si rekomandim dhe zbatuar. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

Gjetja nga auditimi: 19. Procesi auditues evidentoi se: IAL-et ose nuk kanë informacion mbi ecurinë e procesit të pajisjes me kartë studenti, ose në marrëveshjet që kanë nënshkruar me njësitë

e vetëqeverisjes vendore, nuk kanë të përfshira shërbime me çmime të reduktuara për nevojat e lindura në periudhën e pandemisë. Po ashtu, IAL-et, nuk kanë nënshkruar “...marrëveshje me subjekte ...private, për ofrimin e shërbimeve të ndryshme,me çmime të reduktuara për përfituesit e kartës së studentit.”¹⁰, në mungesë të zbatimit të VKM - së Nr. 226, e datës 17.04.2019 “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, pika 6.

Ministria e Arsimit dhe Sporteve të gjitha marrëveshjet i ka lidhur deri në vitin 2019 dhe asnjë në vitet 2020 dhe 2021, duke mos përfshirë në gamën e shërbimeve të ofruara me çmime të reduktuara, objekt marrëveshjesh, asnjë shërbim të lidhur me nevojat e krijuara nga situata e pandemisë.

Ministria e Arsimit dhe Sporteve ka nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me Ministrinë e Kulturës dhe Ministrinë e Brendshme, por nuk ka nënshkruar marrëveshje për shërbimet që: “..ofrohen nga entet shtetërore në fushën..., e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, arsimit, sportit dhe rinisë, transportit,..., ekonomisë, financave, punësimit dhe trajnimit... “që përfitohen nga studentët me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit...”¹¹, në kundërshtim me VKM-në Nr. 226, datë 17.04.2019, në pikën 1.

IAL-et objekt auditimi dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve nuk kanë bërë inventarizim nevojash të studentëve gjatë periudhës së pandemisë, mbi bazën e të cilave të orientonin veprimtarinë e tyre në mbështetje me promovimin e përfitimin e shërbimeve me çmime të reduktuara nëpërmjet kartës së studentit.

Rekomandimi 19. Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe IAL – et, në bashkëpunim me entet shtetërore të fushave të ndryshme, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe operatorët e sektorit privat, të përditësojnë dhe pasurojnë spektrin e marrëveshjeve për shërbimet që përfitojnë studentët me çmim të reduktuar, në përputhje me situatat dhe nevojat e lindura.

MAS

Konstatohet se: Aktualisht, MAS ka realizuar një marrëveshje bashkëpunimi, nr. 995 prot., datë 10.02.2023, me Bashkinë e Durrësit, “Për ofrimin e shërbimeve me çmime të reduktuara për përfituesit e kartës së studentit, delegimin dhe administrimin e kartës së studentit nga Bashkia Durrës”. Marrëveshja ka për qëllim përfitimin me çmime të reduktuara dhe/ose falas brenda territorit nën juridiksionin e Bashkisë Durrës për studentët e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës. MAS synon të realizojë marrëveshje të tilla edhe me bashkinë e Korçës dhe atë të Elbasanit.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga MAS, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, ka filluar zbatimin, por ky rekomandim është në proces, pasi duhet të vazhdojë zbatimin dhe për IAL-et dhe Bashkitë e tjera. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces zbatimi (shtrirje në IAL-et dhe Bashkitë e tjera të vendit).

Gjetja nga auditimi: 20. Rezulton se akoma nuk është miratuar VKM - ja “Për skemën e kreditimit studentor, si dhe kushtet që duhet të plotësojë studenti për aplikim për kredi”, në moszbatim të Ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 114, pika 3. Nismat e marra në kuadër të Paktit për Universitetin, janë të para vitit 2020, të cilat u realizuan në përgjigje të nevojave të studentëve

¹⁰ VKM Nr. 226, e datës 17.04.2019 “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, pika 6.

¹¹ VKM Nr. 226, e datës 17.04.2019 “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, pika 1.

në situatë të zakonshme. Ndërkohë skema e kreditimit studentor, si një instrument i parashikuar nga ligji, mbeti e pa miratuar edhe gjatë periudhës së pandemisë, ku studentët dhe familjet u ballafaquan me vështirësi shtesë.

Rekomandimi 20. Ministria e Arsimit dhe Sporteve si institucioni përgjegjës për arsimin, të marrë masa për hartimin, të sensibilizojë, të nxisë dhe të ndjekë miratimin e VKM - së "Për skemën e kreditimit studentor, si dhe kushtet që duhet të plotësojë studenti për aplikim për kredi".

MAS

Konstatohet se: Është miratuar vendimi nr. 440, datë 19.07.2023 i Këshillit të Ministrave, "*Për përcaktimin e skemës së kreditimit studentor*". Sipas kësaj VKM-je, studenti, me shtetësi dhe vendbanim në Shqipëri, i cili është regjistruar dhe ndjek studimet në një IAL, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për kredi studentore, për financimin e kostove të studimeve. Vendimi fillon të zbatohet për vitin akademik 2023-2024.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga MAS, vlerësohet se është pranuar si rekomandim dhe zbatuar. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

Gjetja nga auditimi: 21. Kërkesa për vënien në dispozicion të personelit mjekësor (mjek apo infermier), për asistimin dhe trajnimin e personelit të Universitetit Politeknik të Tiranës është bërë në zbatim të masave të përcaktuara në Urdhërin Nr. 289 prot., datë, 04.05.2020, të Ministrit të Ministrisë Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale, urdhër i cili në pikën 2 të tij, parashikon: "*Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri, Inspektorati Shëndetësor, ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet e qeverisjes vendore.*"¹². Institucionet e shërbimeve shëndetësore, të cilave iu adresua problematika, nuk u treguan aktivë dhe nuk ofruan bashkëpunimin e kërkuar nga Universiteti Politeknik Tiranë.

Rekomandimi 21. Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe IAL – et, të marrin masa dhe të bashkëpunojnë me institucionet që bëjnë politikat e shëndetit publik dhe sigurojnë zbatimin e tyre, për rastet e fatkeqësive natyrore shkaktuar nga pandemitë, si dhe zbatimin e masave të urdhëruara si të detyrueshme, për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive, përfshirë edhe proceset e vaksinimit.

MAS

Konstatohet se: MAS në bashkëpunim me IAL-të, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e saj të varësisë ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme gjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive, përfshirë edhe proceset e vaksinimit.

Gjithashtu, MAS do të vijojë të marrë çdo masë për të njoftuar dhe sensibilizuar të gjitha institucionet e arsimit të lartë me çdo vendimmarrje të strukturave përgjegjëse në fushën e shëndetësisë, duke respektuar legjislacionin në fuqi lidhur me lirinë akademike dhe autonominë institucionale të IAL-ve.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga MAS, vlerësohet se është pranuar si rekomandim, dhe zbatuar. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

¹² Urdhëri Nr. 289 prot., datë, 04.05.2020, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, "Për miratimin e Udhëzuesit për "Masat ndaj Covid 19 që duhet të ndërmarrin institucionet e arsimore", pika 2.

Gjetje nga auditimi: 22. Procesi i vaksinimit para fillimit të vitit akademik 2021 – 2022, i iniciuar në zbatim të Urdhrit të MSHMS – së, Nr. 413, datë 24.09.2021 “Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit covid -19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët” dhe Urdhrit të MSHMS - së, Nr. 413/1, të datës 27.09.2021 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 413, datë 24.09.2021 “Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit covid -19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët”, i cili ishte kusht për praninë e studentëve në auditore, nuk u përvijua nga IAL –et, në respekt të plotë të sa parashikuar në këto dy akte. Detyrimi i parashikuar në pikën 1, të Urdhrit Nr. 413/1, datë, datë 27.09.2021, që “Studentët duhet të paraqesin certifikatën e vaksinimit COVID-19 apo kartën e vaksinimit, për të hyrë në institucionet e arsimit të lartë, duke filluar nga data 11.10.2021”¹³, nuk është respektuar dhe zbatuar nga IAL – et me rigorozitet dhe studentët kanë qenë të pranishëm në auditore pavarësisht mos vaksinimit të tyre, meqë edhe alternativa e mësimi online për të pavaksinuarit, u hoq pas ndryshimit të pikës 4 të Urdhrit nr. 413, me parashimin e pikës 1 të Urdhrit Nr. 413/1.

Rekomandimi 22. Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe IAL – et, të marrin masa dhe të bashkëpunojnë me institucionet që bëjnë politikat e shëndetit publik dhe sigurojnë zbatimin e tyre për rastet e fatkeqësive natyrore shkaktuar nga pandemitë, si dhe zbatimin e masave të urdhëruara si të detyrueshme, për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive, përfshirë edhe proceset e vaksinimit masiv.

MAS

Konstatohet se: MAS në bashkëpunim me IAL-të, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e saj të varësisë ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme gjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive, përfshirë edhe proceset e vaksinimit. Gjithashtu, MAS do të vijojë të marrë çdo masë për të njoftuar dhe sensibilizuar të gjitha institucionet e arsimit të lartë me çdo vendimarrje të strukturave përgjegjëse në fushën e shëndetësisë, duke respektuar legjislacionin në fuqi lidhur me lirinë akademike dhe autonominë institucionale të IAL-ve.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit paraqitur dhe verifikimit të kryer për sqarimet e dhëna nga MAS, vlerësohet se është pranuar si rekomandim dhe zbatuar. Në këto kushte nga grupi i auditimit rekomandimi quhet i pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe zbatuar.

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në përfundim të procesit të auditimit, mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH të përcjella me shkresën shkresat nr. nr.103/22,23,24,25,26,27prot, datë 01.11.2022 , konstatohet se një pjesë e tyre është në proces zbatimi ose e zbatuar pjesërisht. Duke vlerësuar se është punuar dhe ka patur vlerësim të mirë, por dhe për arsye se disa rekomandime kanë fushë zbatimi kohor në vijimësi, dhe për të rritur nivelin e menaxhimit të IAL-eve, ri-kërkojmë zbatimin e rekomandimeve, si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1.1. Për pyetjen audituese: A janë zbatuar politikat, aktet ligjore dhe nënligjore të dala, si dhe udhëzimet e Komitetit të ekspertëve?

¹³ Urdhëri i MSHMS - së, Nr. 413/1, të datës 27.09.2021 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 413, datë 24.09.2021 “Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit covid -19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët”, pika 1.

Gjetje nga auditimi: 1. Nga verifikimi i dokumentave dhe akteve, lidhur me politikat në fushën e mbrojtjes civile dhe zbatimin e tyre, u konstatua se *nuk është miratuar një Strategji Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, në shkelje të nenit 10, pika 1, i cili përcakton se:* “Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë është dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë që përcakton politikat e aktivitetet e institucioneve dhe të strukturave qendrore e vendore, si dhe të gjitha subjekteve të tjera në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit” edhe pse është në zbatim Ligji Nr. 45/2019.

Mungesa e strategjisë është në kundërshtim me objektivin e pestë të kuadrit SENDAI¹⁴ të reduktimit të riskut të fatkeqësive: “Rritja në mënyrë thelbësore e numrit të vendeve me strategji të reduktimit të riskut kombëtar dhe lokal të fatkeqësive deri në vitin 2020”.

Mungesa e strategjisë evidentohet si një mangësi në gjetjet e njëpasnjëshme të raporteve të progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, përfshirë edhe raportin e progresit të fundit për vitin 2018¹⁵. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion prej MAS, rezulton se në PPAP (planifikimi i proceseve të aktivitetit të programuar) 2022 të Ministrisë së Mbrojtjes, është parashikuar miratimi i Strategjisë, në katërmujorin III të vitit 2022. Bazuar në Urdhrin të Kryeministrit nr. 57, datë 29.06.2021 (nr. prot. 3664, datë 29.06.2021, protokoll të Ministrisë) “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës për përgatitjen e projektit të Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë”, ka filluar puna për hartimin e saj dhe referuar pikës 2, germa dh, të njëjtit urdhër, anëtar i Grupit Ndërinstitucional të punës, në përfaqësim të MASR, është Zëvendësministri i këtij dikasteri.

1.2. Po ashtu, u konstatua se edhe pse është në zbatim Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, datë 18.07.2019, nuk është miratuar ende një Plan Kombëtar për Emergjencat Civile. Duke qenë se Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 14, pika 4, parashikon se: “Plani Kombëtar për Emergjencat Civile miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit”¹⁶, atëherë shtrohet nevoja përgatitjes dhe miratimit të tij, sapo të jetë miratuar Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.

1.3. Konstatohet se MAS, në zbatim të Ligjit Nr. 8756, datë 26.03.2001, ka miratuar më datë 08.08.2019, me nr. 7856 prot., “Rregulloren për parandalimin e gjendjes së fatkeqësive natyrore, ose të fatkeqësive të tjera dhe masat e jashtëzakonshme”¹⁷. Kjo ministri, ka detyrim, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, datë 18.07.2019, neni 22, pika 2, germa a, të hartojë, miratojë dhe përditësojë planin për emergjencat civile, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore dhe ta dërgojë atë në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllime analize dhe planifikimi, ndërkohë që akoma nuk e ka miratuara një dokument të tillë, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, datë 18.07.2019

Rekomandimi 1. Ministria e Arsimit dhe Sportit nëpërmjet përfaqësuesit të saj, të kontribuojë pranë Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës për përgatitjen e projektit të Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga fatkeqësitë, duke pasuruar me përvojat dhe nevojat e shfaqura edhe gjatë periudhës së pandemisë nga Covid-19 në IAL – e publike shqiptare në përmbajtjen e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Të sensibilizojë të gjithë mekanizmat politikëbërës dhe vendimmarrës, për miratimin sa më të shpejtë të saj. Ministria e Arsimit dhe Sporteve pas miratimit të strategjisë Kombëtare për

¹⁴ Sendai është një qytet prej një million banorësh në Japoni, ku me 15 mars 2015, shtetet anëtare të OKB - së u mbledhën në Konferencën Botërore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, ku u miratua dokumenti I njohur si Kuadri i Sendait, më pas I aprovuar nga Asamblea e Kombeve të Bashkuara në qershor 2015

¹⁵ <https://parlament.al/Files/ProjektLigje/20190610101549RELACION%20%20MBROJTA%20CIVILE.pdf>

¹⁶ Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 14, pika 4.

¹⁷ Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 22, paragrafi 1 dhe 2, germa a. dhe b.

Zvogëlimin e Riskut nga fatkeqësitë, të përgatisë dhe ndjekë miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile.

Rekomandimi 1.2. Ministria e Arsimit dhe Sporteve të miratojë dhe përditësojë planin për emergjencat civile, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore të ngarkuar, sapo të jetë miratuar Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Planit Kombëtar për Emergjencat Civile.

Në vijimësi

B. MASA ORGANIZATIVE

Për pyetjen audituese:

1.1.1 A janë zbatuar politikat, aktet ligjore dhe nënligjore të dala, si dhe udhëzimet e Komitetit të ekspertëve?

Gjetja nga auditimi: 2. IAL-et duke mos njohur Rezolutën 2001/C 204/02, e njohur si Rezoluta mbi e-learning, e miratuar nga Këshilli i Ministrave të Arsimit të vendeve anëtare të BE më 13 Korrik 2001 mbi e-learning, dëshmojnë se kanë mangësi lidhur me informacionin që lidhet me praktikën e e-learning, të rekomanduar që para disa dekadave në vendet e BE - së.

Rekomandimi 2. "IAL-të (UNIEL, UNIKO, UGJ dhe UNIVlorë) të thellojnë njohuritë e veta mbi dokumentet dhe praktikën e mira të e-learning, me qëllim reflektimin e tyre në proceset e tyre mësimore".

Në vijimësi

Për pyetjen audituese:

1.1.2. A i ka shërbyer ky kuadër arritjes së objektivave të mësimëdhënies, kërkimit shkencor dhe mbrojtjes së shëndetit të studentëve dhe stafit akademik?

Gjetja nga auditimi: 3. Këshillat studentorë, ndryshe nga sa parashikohet në Ligjin Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nen 99, sikurse konstatohet nga përgjigjet e dhëna nga IAL-et, ose nuk janë ngritur dhe funksionuar, ose nuk kanë qenë aktiv, gjatë periudhës pandemisë. Ndaj, studentëve u kanë munguar zëdhënësit e drejtpërdrejtë të tyre dhe problemeve të cilat i kanë shqetësuar gjatë kohës së pandemisë shkaktuar nga Covid 19.

Rekomandimi 3. Institucionet e Arsimit të Lartë (UPT, UNIKO, UGJ) pa cënuar lirinë e organizimit të studentëve në këshilla studentorë, të nxisin, inkurajojnë dhe mbështesin, ngritjen dhe funksionimin e këshillave studentorë, me synim diskutimin, trajtimin dhe zgjidhjen e problematikave me të cilat ndeshen studentët.

Brenda muajit dhjetor 2023

Për pyetjen audituese:

1.1.2. A i ka shërbyer ky kuadër arritjes së objektivave të mësimëdhënies, kërkimit shkencor dhe mbrojtjes së shëndetit të studentëve dhe stafit akademik?

Gjetja nga auditimi: 4. Procesi auditues evidentoi se: IAL-et ose nuk kanë informacion mbi ecurinë e procesit të pajisjes me kartë studenti, ose në marrëveshjet që kanë nënshkruar me njësitë e vetëqeverisjes vendore, nuk kanë të përfshira shërbime me çmime të reduktuara për nevojat e lindura në periudhën e pandemisë. Po ashtu, IAL-et, nuk kanë nënshkruar "...marrëveshje me subjekte ...private, për ofrimin e shërbimeve të ndryshme,me çmime të reduktuara për

*përfituesit e kartës së studentit.*¹⁸, në mungesë të zbatimit të VKM - së Nr. 226, e datës 17.04.2019 “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, pika 6.

Ministria e Arsimit dhe Sporteve të gjitha marrëveshjet i ka lidhur deri në vitin 2019 dhe asnjë në vitet 2020 dhe 2021, duke mos përfshirë në gamën e shërbimeve të ofruara me çmime të reduktuara, objekt marrëveshjes, asnjë shërbim të lidhur me nevojat e krijuara nga situata e pandemisë.

Ministria e Arsimit dhe Sporteve ka nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me Ministrinë e Kulturës dhe Ministrinë e Brendshme, por nuk ka nënshkruar marrëveshje për shërbimet që: “..ofrohen nga entet shtetërore në fushën..., e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, arsimit, sportit dhe rinisë, transportit,..., ekonomisë, financave, punësimit dhe trajnimit... “që përfitohen nga studentët me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit.”¹⁹, në kundërshtim me VKM-në Nr. 226, datë 17.04.2019, në pikën 1.

IAL-et objekt auditimi dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve nuk kanë bërë inventarizim nevojash të studentëve gjatë periudhës së pandemisë, mbi bazën e të cilave të orientonin veprimtarinë e tyre në mbështetje me promovimin e përfitimin e shërbimeve me çmime të reduktuara nëpërmjet kartës së studentit.

Rekomandimi 4. Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe IAL – et, në bashkëpunim me entet shtetërore të fushave të ndryshme, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe operatorët e sektorit privat, të përditësojnë dhe pasurojnë spektrin e marrëveshjeve për shërbimet që përfitojnë studentët me çmim të reduktuar, në përputhje me situatat dhe nevojat e lindura.

Në vijimësi

Gjetja nga auditimi: 5. Universiteti “Eqerem Çabej” Gjirokastrë në kryerjen e aktivitetit të mësimdhënies, kërkimore-shkencore kualifikuese, inovative, si edhe praktikave mësimore e laboratorë në periudhën objekt auditimi 2020-2021, nuk administron pasuritë e paluajtshme në pronësi, por i ka ato në përdorim.

Rekomandimi 5: “Drejtuesit e universitetit “Eqerem Çabej” Gjirokastrë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të marrin masa dhe të përgatisin dokumentacionin e nevojshëm për të ndjekur procedurat ligjore për kalimin në pronësi të pasurive të paluajtshme që ky institucion ka në inventar”


Brenda muajit Qershor 2024

Shënim: *Të gjithë punonjësit që atakohen në këtë projekt raport auditimi duhet tu bëhen prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht tu jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë.*

Grupi i Auditimit

1. Bajram LAMAJ,
2. Aleksandra TREBICKA,
3. Ardian SIMONI,

përgjegjës grupi
anëtare
anëtar



DREJTORI I DEPARTAMENTIT

Alfred ZYLFI

¹⁸ VKM Nr. 226, e datës 17.04.2019 “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, pika 6.

¹⁹ VKM Nr. 226, e datës 17.04.2019 “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, pika 1.

Aneksi 1
Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Auditim performance me temë : *“Performanca e Universiteteve Publike gjatë periudhës së pandemisë”*

Në 000/lekë

Nr .	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vler a lekë	Nr .	Vle ra	Nr .	Vl er a	Nr.	Vl er a	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr .	Vle ra	Nr.	Vlera	Nr .	Vle ra	Arkët uar	Mbet ja	Nr .	Vle ra	Nr .	Vle ra
1	Masa për ndryshim apo përmirësim legjislatoni	3		3				100%		2				1							
2	Masa organizative	19	-	19	-		-	100%	-	15	-	-	-	4	-	-	-	-	-	-	-
3	Masa shpërblim dëmi																				
4	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																				
5	Për eliminimin e efekteve																				
6	Masa disiplinore																				
7	Masa Administrative																				
TOTALI		22	-	22	-		-	100 %	-	17	-	-	-	5	-	-	-	-	-	-	-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

Vlorë më, 18 . 09 . 2023

Lënda : Ngarkohen për zbatimin e shkresës bashkëlidhur në respektim të legjislacionit përkatës në fuqi :

Drejtuar:

- Senati
- Rektorati
- Këshilli Etikës
- Rektori
 - Qendra Studimore e Zhvillimit Rajonal
 - Sektori Juridik
 - Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore
 - Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës
 - Sektori i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun
 - Sektori i IT-së
- Bordi i Administrimit
- Administrator
 - Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
 - Sektori i Financës dhe Realizimit të Buxhetit
 - Sektori i Prokurimeve
 - Sektori i Shërbimeve
- Njësia e Auditit të Brendshëm
- Zv. Rektor për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Insitucional
 - Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve
 - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional
 - Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë
- Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik
- Zv. Rektor Akademik
 - Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë
 - Sektori i Kurikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve
 - Sektori i Këshillimit të Karrierës Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore Sportive
- Sektori i Bibliotekes Shkencore
- Prof. Asoc. Aurela Saliaj Dekan F.SH.
 - Kryesekretare F.SH.
- Prof. Dr. Albert Qarri Dekan F.E
 - Kryesekretare F.E
- Prof. As. Armela Panajoti Dekan F.SH.H
 - Kryesekretare F.SH.H
- Prof.As. Hajdar Kicaj Dekan F.SH.T.N
 - Kryesekretare F.SH.T.N

REKTORI
Prof. Dr. Roland ZISI